

# NACIONAL

Gazeta e përditshme online:  
www.gazeta-nacional.com

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucapaj@yahoo.com

Tre vjet nga publikimi i parë i gazetës kombëtare "Nacional"

**Nacional, gazeta më e madhe kulturore**

faqe 21



Pse në Shqipëri nuk ishte aplikuar më parë teoria dhe filozofia e protonizmit

**Nacional dhe Marinaj themeluan Protonizmin**

Nga Mimoza Erebara

faqe 8



"Nacional grup" dhe gazeta "Nacional" japin çmimin vjetor "Albanian BookerMan"

## EDITORIAL

"Nacional" promovuesja e lëvizjeve të reja letrare

Nga Shahbaze Vishaj



të rëndësishme të artit në përgjithësi në Shqipëri dhe në Kosovë. Edhe pse me moshë të re (sapo ka shkelur në vitin e katërt të botimit), kjo javore letrare e kulturore bëri për vete shtresa të gjëra lexuesish të mirëfilltë, pra edhe krijuesish, ku publikojnë...

Faqe 6

Marinaj pasurues i kritikës botërore

Nga Vjollca Tytyni



paruar kritik. Krijimtaria e tij letrare, poetike e studimore, flet bukur, qartë dhe kuptueshëm. Ndonëse i vonë në këtë fushë, letërsisë sonë i ka sjellur një pasuri të artë letare, e cila e bën Marinajn, një kritik të mprehtë dhe të talentuar. Duke e sjellur dhe përparuar në...

Faqe 9

# Gjekë Marinaj merr Çmimin "Albanian BookerMan"

Çmimi jepet për arritjen më të shquar vjetore në fushë të kritikës

faqe 2-3



Marinaj rrëfen emocionet pas marrjes së çmimit "Albanian BookerMan"

faqe 4-5

## Në BRENDËSI

Protonizmi na inkurajon të gjejmë vlerat  
Studim nga Kristen M. Walker

faqe 7

Marinaj, një mendje mes dy kontinenteve  
Studim nga Zymber Elshani

faqe 8

Protonizmi të mësohet në universitete  
Kritikë nga Rudina Çupi

faqe 16

Struktura e terrorit letrar  
Esse nga Çerçiz Loloçi

faqe 18

I kam prerë lidhjet me zemren  
Poezi nga Yllka Filipi

faqe 20

Nacional frymëzuese e lëvizjeve të reja letrare  
Kritikë nga Ilir Paja

faqe 15

Imazh ngjyrash të detit dhe dashurisë  
Kritikë nga Mustafa Spahiu

faqe 18

Natë në mal  
Poezi nga Musa Vyshka

faqe 19

Poezi nga:  
Tonin Alimhilli, Aleksander Çipa, Flora Rogova, Novruz Xh. Shehu

faqe 17



www.radionacional.al



bookstore.al

T: +355 389 250

M: +355664062064 @: e.zajmi@bookstore.al

TEG



“Nacional grup” dhe gazeta “Nacional” japin çmimin vjetor “Albanian BookerMan,” për

# Gjekë Marinaj merr Çmimin

Një juri e ngritur pranë redaksisë ka menduar që fitues i çmimit “Albanian BookerMan”, për vitin 2011 të jetë Gjekë Marinaj, për promovimin e një lëvizje të re letrare në botë, të njohur me termin “Protonizëm”

Mujë Buçpapaj



Gjekë Marinaj (Photo by Richard Chambers)

“Nacional grup”, dhe gazeta “Nacional” si pjesë e kësaj sipërmarrje mediatike dhe botimesh, nisur nga një praktikë e njohur ndërkom-bëtare kanë vendosur që të japin çmimin vjetor “Albanian BookerMan”, për arritjen më të shquar vjetore në fushë të krijimtarisë letrare, studimeve, përkthimeve dhe kritikës.

Një juri e ngritur pranë redaksisë ka menduar që fitues i çmimit “Albanian BookerMan”, për vitin 2011 të jetë Gjekë Marinaj, për promovimin e një lëvizje të re letrare në botë, të njohur me termin “Protonizëm”.

Marinaj është pedagog i gjuhës dhe komunikimeve Angleze dhe i lëndës së Letërsisë Botërore në Richland College në Dallas të Teksasit, (Master of Arts in Humanities—Studies in Literature) në UT Dallas, ndërsa është Kandidat për Ph.D (Doktor i Filozofisë) po në Universitetin e Teksasit në Dallas.”

Protonism (në shqip “Protonizëm”) është emri që Marinaj ka propozuar për miratim në Konferencën e Profesorëve të Letërsisë Botërore në Des Moines, Ioëa, në dhjetor të vitit 2005, si një lloji i veçantë këndvështrimi kritik, i njohur zyrtarisht nga ky institucion, në vitin 2011.

Së dyti, Marinaj është njëri prej kontribuesve më të rëndësishëm në suksesin e gazetes “Nacional”, me shumë kritika dhe studime të një niveli shumë të lartë, të përfshira edhe në librin “Protonizmi : Nga teoria në praktikë, Vizione letare”(Shtëpia Botuese “Nacional”, Tiranë 2011), por edhe pse konsiderohet si ambasador i letërsisë shqipe në SHBA.

Marinaj ka ndërmjetësuar botimin e disa poetëve shqiptarë në SHBA, ka futur Kadarenë në programet universitare amerikane, ka botuar në anglisht bashkë me Frederik Turner tekstin e “Epika legjendare shqiptare” që do të hyjë si tekst i rekomanduar universitar në vitin 2013, si dhe ka publikuar shumë kritika dhe studime për letërsinë bashkëkohore shqiptare në shtypin prestigjioz, letrar të SHBA-ve. Ka përkthyer keto ditë dhe botuar në anglisht poetin Preç Zogaj, si dhe është duke vijuar me shumë pasion përkthimin dhe botimin në SHBA të poetëve tjerë shqiptarë.

Për të promovuar këtë sukses ndërkombëtar të zotit Marinaj, gazeta Nacional ka menduar që këtë numër t’ia dedikojë këtij evenimenti në mënyrë të zgjeruar. Me këtë rast më kërkesë të redaksisë një numër poetësh, shkrimtarësh dhe studiuesish të letërsisë kanë shprehur mendimin e tyre për këtë vizion të ri të kritikës letrare,

të njohur si protonizëm, si dhe për rolin e zotit Marinaj, në fushë të kritikës bashkëkohore .

Gazeta Nacional është shumë e nderuar nga pjesëmarrja në debatin rreth protonizmit, të shumë kritikëve, studiuesve dhe shkrimtarëve të mirënjohur nga të gjitha hapësirat shqiptare si dhe atyre të huaja.

Gjekë Marinaj, ka një meritë të madhe për promovimin e një lëvizje të re letrare në botë, të njohur me termin “Protonizëm”, e cila ka gjetur jehonë edhe në shtypin amerikan.


Revista Amerikane “Transparent Eyeball” e cilë-

vendeve të ndryshme të botës. Për shembull, si mund t’i shërbejë Protonizmi tërë njerëzimit nëse ky sugjerim implimtohet sa e si duhet në trajtimin e aspekteve historike të ngjarjeve të tyre më të spikatura?

Por Protonizmi është i aplikueshëm edhe në fushat e ndjeshme e të mprehta për çështjet e kulturës së etnicitetit. Për shembull letërsia e e Kosovës është thellësisht të përfshirë në procesin e zhurmshëm të këtij përkufizimi. Në këtë kolektiv kombëtar të përbashkët historia nuk

pikën e ndërthurjes së krijuesve dhe gazetarëve pa emër të madh me ata që janë figura të njohura të letërsisë dhe gazetarisë tonë gjatë këtyre 4 viteve të botimit?

Protonizmi, në fund të fundit, është një teori letrare që kërkon nga kritikët letrar të bazohen në veprën e autorit dhe jo në reputacionin që ka ai falë rrethanave të ndryshme në favor apo disfavor të tij. A është aplikuar sa duhet teoria dhe filozofia e Protonizmit në kritikën tonë në Shqipëri dhe hapësirat shqiptare, apo edhe në



son Protonizmin si një teori letrare që po të zbatohet në potencialin e plotë që ka, do të ndihmonte në përmirësimin jo vetëm të fushës së letërsisë por edhe të shumë fushave të tjera të artit dhe shkencës.

Protonizmi nxit dhe frymëzon një dialog të hapur ankoruar në seriozitetin e qëndrimit filozofik të kritikës në letërsinë globale bashkëkohore. Posaçërisht për kulturën letrare shqiptare Protonizmi thekson fuqishëm faktin se kritika letrare duhet të ketë gjithmonë në mendje ata lexues dhe studiues të cilët janë të orientuar kundrejt ndershmërisë intelektuale dhe impulseve etike. Nisur nga kjo teori e re, Protoniste, pyetja që shtrohet është nëse duhet t’i rishikojë kritika letrare nocionet tradicionale të kulturës dhe kriteret që përcaktojnë fatin e lexuesit në kulturës tonë?

Protonizmi sugjeron një intensitet në rritje kundrejt përpjekjeve tona për të shqyrtuar, artikulluar dhe harmonizuar, një konglomerat idesh në ndihmë të esencën historike të letërsisë së

është aq e zakonshme. Pyetja është se si mund të përfitojnë kritika e re shqiptare nëse e vë në veprim filozofinë e Protonizmit për t’i trajtuar të gjithë krijuesit dhe lexuesit e tyre në nivelin individual duke u mbështetur në veprimet më të mira të shoqërisë qoftë edhe duke sakrifikuar qetësinë apo principet personale ?

Po kështu intensiteti i veprimtarisë letrare si reflektim kritik mund të marrë zanafillën e vet edhe në artin e muzikës mbarë shqiptare. Sipas teorisë së Protonizmit, muzika është një art i shkëlqyer që mund të luaj një rol instrumental në segmentet e edukimit dhe argëtimit të popujve.

Është e qartë se për arsye praktike dhe logjike revistat letrare shpesh përputhen me revistat akademike, por është gjithashtu e vërtetë se ngushtimi i distancës në mes tyre është në mënyrë periodike në shënjestër të kritikave.

Mendoj se “Nacional” si botuese dhe rekomanduese e librit të Marinajt “Protonizmi: nga teoria në praktikë” dhe kësaj teorie në përgjithësi i ka justifikuar sa duhet mësimet e Protonizmit në

artet e tjera shqiptare, kjo mbetet për t’u parë, sidomos a tregojnë Protonizëm ndaj arteve politikanët e vendeve ku banojnë shqiptarët? Në shumë vende të botës Shkencat Humane dhe Sociale kanë kthyer sytë nga qeveritë e tyre respektive për ndihmë financiare dhe reklamuese të veprave me të mira të artit. Protonizmi jep një nxitje indirekte të këtij problemi si një kategori analitike që duhet të tërheq vëmendjen e votuesve për marrëdhëniet e tyre të brendshme midis pushtetit dhe krijuesve.

Dhe më tej çfarë e bën një kritik letrar apo qoftë edhe një shoqëri të mos gjendet brenda kuadrantit të Protonizmit? Ngatërruar në një grup më të madh të nocioneve që shpesh gropë shoqërore ndaj individit, normative kundër tabu, dhe pritë kundër habitshme, kuriozitetet gjeneruar pyetje në lidhje me dëshirën, shijet, njohuritë, biles edhe në hetimin ndaj së kaluarës.

Protonizmi shtron nevojën për të interpretuar të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen letrare me dashamirësi dhe jo vrrer. Si mund të Proton-



arritjen më të shquar vjetore në fushë të kritikës

# “Albanian BookerMan”



Në foto nga e majta në të djathtë:  
Nikolla Spathari, Gjovalin Shkurtaj, Gjeke Marinaj, Mujë Bucpapaj, Tom Thercaj

izohet një shtytës për aktivitet letrar dhe një përshkrim për aktivitetet filozofike në të mirë të jetës gjithënjëzore?

## Nën ombrellën e protonizmit

Gjekë marinaj ka zbatuar më shumë ide të protonizmit se çdo lloj tjetër të kritikës letrare. dhe të shpjegimit të tij si mekanizëm për t'u dhënë jetë ideve të tij në lidhje me vlerat në letërsi, është me vend të shpjegojmë se Marinaj ka një rol individual si një kritik letrar i nivelit botëror, lidhur me tërësinë e letërsisë që prodhohet në botë.

Sic thote vete Marinaj, “parë nga ky kënd, edhe kritika letrare, si fizika, e ka “atomiken” e vet dhe kjo “atomikë” është e pranueshme për sa t’u përmbahet ligjeve përkatëse. Pra rreth bërthamës së letërsisë shqipe, si edhe asaj botërore, kemi parë plot kritikë letrarë që sillen tamam si elektrone, të predispozuar të përçojnë gjithë jetën vetëm energji negative. Ata shpesh janë të zymtë nga pozicioni që gëzojnë profesionalisht, nga shijet që kanë për artin dhe fjalën e shkruar artistike, vuajnë shpirtërisht ngaqë ndërjegjen nuk e kanë kurrë të qetë, dhe më e keqja, në syrin e shumicës jetojnë nën etiketën e letrarëve të dështuar. Kjo ndodh se kur shkruajnë për një libër, apo komentojnë rreth filanit, jo rreth një autori, ata nuk shkruajnë duke gjykuar veprën e tij, por veten e tyre, smirën që kanë fituar nga sukseset e të tjerëve, dështimet e veta në jetë, e nganjëherë, zbulojnë veten duke u orvatur të tërheqin të tjetër poshtë ngaqë nuk arrijnë dot të ngjiten në nivelin e tyre.

Po kështu të gjithë jemi dëshmitarë të asaj pjese të kritikës që brenda bërthamës letrare vepron me ngadalshmëri pa ndonjë ngarkesë elektrike pozitive apo negative. Ata mundohen të japin e të marrin duke u përpjekur të jenë sa më racionalistë. Tradicionalisht këta soj kritikësh kanë mbetur si më të respektuarit. Ata mundohen të gjykojnë sa artin aq edhe autorin. Të zhveshur nga çdo barrierë e jashtme, punojnë me librin duke zgjedhur për lexuesin ato gjëra që ata mendojnë se kanë më vlera, pa lënë pas as mangësitë.

Për fat të mirë, protonistët veprojnë apo reagojnë drejt letërsisë me ngarkesa të mjaftueshme “ele-

trike” te karakterit pozitiv sa të mbajnë në ekuilibër apo të barazojnë numrin e “ngarkesave negative të “elektroneve”. tek protonistët, mbizotëron thelbi njerëzor, shpirti human, dëshira për të inkurajuar të tjerët, për të dalluar vetëm të bukurën në gjithçka e në këdo, pra mbizotëron ajo pjesë e shkrimtarit që e ka bërë botën letrare kaq moderne sa ç’ e kemi sot.

Protonisti gjen diçka të mirë për të thënë për një numër të konsiderueshëm shkrimtarësh e poetësh, si një kritik letrar i tipit të ri, si një kritik protonist.

Kjo, jo se ai nuk është në gjendje ta dallojë të mirën prej të keqes në letërsi. Kur ai ka ditur të dallojë të mirën, do të thotë se bagazhi i tij ka njohuri të mjaftueshme për etikën në letërsi. Kur ai ka aftësitë të komentojë me aq pasion e kompetencë për të bukurën, do të thotë se horizonti kulturor i tij i plotëson kërkesat e një gjykuesi të denjë të estetikës letrare.

Ne e dime se jo të gjithë autorët kanë arritur përsosje në krijimtarinë e tyre. Por ai është i vetëdijshëm se koha, talenti, e mbi të gjitha shpirti madhështor i tij si njeri, janë shumë më efektive në kërkim të së bukurës se sa të së shëmtuarës në letërsi.

Në këtë pikë ai do të respektohet jo vetëm nga krijuesit, por edhe nga kritikët, sidomos nga ata kritikë që e gjykojnë letërsinë në aspektin ekokritikal (ecocritical). Ekokritikët i kërkojnë rrënjët e veta jo në momentet politike, jashtë sferave të studimit të letërsisë, siç bënin marksistët e nganjëherë feministët, por tek lëvizjet ambientale dhe tek historia e gjatë e letërsisë së shkruar me subjekt kryesor natyrën. Ajo që do të dëshiroja që të mbanin mend lexuesit e këtij shkrimi është fakti se edhe tek natyra, dhe tek njerëzit, pavarësisht nga përzgjedhja e tyre, po të kërkosh në brendësi të tyre do të gesh si gjëra që mbajnë erë të mirë ashtu edhe gjëra që mbajnë erë të keqe. Shumica e njerëzve do u bashkohen ekokritikëve dhe protonistëve.”

## PROTONIZMISI VIZIONLETRAR

### Nga Gjekë Marinaj

Protonizmi është një teori e re letrare si për letërsinë shqipe ashtu edhe për atë botërore. Si perceptim lingvistik e përshtatjet terminologjike është

të bazuar në linjat shkencore të kimisë dhe fizikës, më saktë në fjalën *Proton* që si pjesë përbërëse e bërthamës së atomit ka ngarkesë elektrike pozitive +1. Protonizëm, në kuptimin më të thjeshtë, do të thotë të shkruash rreth një veprë letrare apo artistike me qëllim pozitiv, i shtyrë nga dashamirësia jo nga vëri.

Në nivele më të thella letrare, natyrisht, Protonizmi është interpretimi i hipotezës të së njohurës në kuptimin metafizik dhe i të njohurës jo deri në fund në kuptimin filozofik. Ai është pjesë esenciale e parametrave të etikës, dhe shërben si orientim që i besojmë tek ndërmarrim udhëtime instinktive apo të menduara drejt sferave të së vërtetës objektive në letërsi dhe art.

Pikërisht kjo pikë e mendimit e ndanë Protonizmin si vizion letrar nga arti tradicional i kritikës letrare e artistike. Protonizmi është degë e arteve dhe humanizmit, jo patjetër degë e shkencës mbi letërsinë dhe artin.


Ndonëse të dyja merren seriozisht me analizimin e gjithanshëm të veprave letrare e artistike, kritika letrare e traditës tenton ta analizojë dhe ta vlerësojë letërsinë e artin nisur nga ana ideore në bazë të parimeve të miratuara nga një ideologji e caktuar në një kohë të caktuar, duke u përqendruar si në anët pozitive ashtu edhe në ato negative të një veprë. Protonizmi, në kontrast, është gjithmonë në ekuilibër jo me ideologjitë politike, por me kërkesat ideore e artistike të kohës, duke mos u ndalur fare tek mangësitë për t’u përqendruar plotësisht vetëm në analizimin dhe nxjerrjen në pah të anëve pozitive dhe të së bukurës në letërsinë dhe artin që trajton.

Shpresoj që duke ofruar Protonizmin si një alternative të re për trajtimin letrar, do të vëmë re se mënjanimi i negativës merr kahe pozitive në rolin estetik, në subjektivizmin dhe objektivizmin e observimit të realitetit, si dhe në molimfeshin e shumëfishitë të humanizmit. Përqendrimi im akademik ka si epiqendër përpjekjen për t’i dhënë jetë këtij tabani të ri teorik. Një lëvizje e tillë, natyrisht, duhet të mbështetet në njëfarë filozofie të para-supozuar, dhe zbulimet e bëra duhet të tërheqin pas vete implikimet metafizike dhe epistemologjike që mbart në vetvete Protonizmi.

### Gjekë Marinaj, pedagog i gjuhës dhe komunikimeve Angleze dhe i lëndës së Letërsisë Botërore në Richland College në Dallas

Gjekë Marinaj (1965) u lind në Brrut të Malësisë së Madhe. Ka botuar disa libra me poezi, prozë dhe përkthime. Në vitin 2001 ka mbaruar Fakultetin e Shkencave të Përgjithshme (Associate in Science) në Brookhaven College. Katër vjet më vonë, mbaroi Shkollën e Arteve dhe Humanizmit (Bachelor of Arts in Literary Studies: Magna Cum Laude) në Universitetin e Teksasit në Dallas. Shkollën e Arteve dhe Humanizmit (Master of Arts in Humanities—Studies in Literature) e mbaroi në vitin 2008 në UT Dallas. Aktualisht vazhdon Doktoraturën: ku është Kandidat për Ph.D (Doktor i Filozofisë) po në Universitetin e Teksasit në Dallas.

Në vitin 2003 është nderuar me Çmimin *Pena e Artë* nga SHSHSHA. Çmimin e *Parë* në poezi, akorduar nga revista letrare amerikane *Sojourn*, e pranoi në vitin 2006. QNK (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës) e nderoi me çmimin *Pjetër Arbunori* në Letërsi në vitin 2008. Marinaj është pedagog i gjuhës dhe komunikimeve Angleze dhe i lëndës së Letërsisë Botërore në Richland College në Dallas të Teksasit ku jeton me gruan e tij Dusita.





Studiuesi i letersise Gjekë Marinaj rrefen në "Nacional" emocionet e tij pas marrjes së Çmimit Albanian BookerMan

# Marinaj: Çmimin e konsideroj një nder të madh me përmasa interpersonale

-“Gazeta Nacional është një fenomen imanent në kulturën bashkëkohore shqiptare. Ajo ka gjetur një mënyrë për të tendosur atë pjesë të humanizmit shqiptar që u tkurrur—më parë nga simptomat epileptike e vonë nga dhënia shpirt—e gazetës Drita.”



Në foto: Gjekë Marinaj, Ed Gracia dhe Mujë Buçpapaj

**Mujë Buçpapaj:** Kompania Mediatike dhe e Botimeve “Nacional Grup” ku përfshihet edhe gazeta Nacional, nisur nga një praktikë e njohur ndërkombëtare kanë vendosur që t’u japin çmimin vjetor Albanian BookerMan Prize, për arritjen më të shquar vjetore për vitin 2011 në fushë e Kritikës Letrare me librin Protonizmi: Nga teoria në praktikë. Si e vlerësoni këtë nderim?

**Gjekë Marinaj:** Çmimin Albanian BookerMan e konsideroj një nder të madh me përmasa interpersonale për dy arsye që në natyrën filozofike rezonojnë si centrifugale. Të parën do e krahasoja me një parabolë matematike. Të dytën me një hiperbolë letrare.

Parabola që të jetë parabolë duhet të jetë subjekt tek disa veti specifike. Edhe shkrimtari që të jetë shkrimtar duhet të përmbushin kërkesat minimale për t’u konsideruar shkrimtar. Kjo dhunti artistike nuk është vetëm një segment i zgatur nga ligjet e natyrës por fitohet në akord me linjat epistemologjike. Edhe unë, gjatë rrugës për tek kjo teori letrare jam fuqizuar nga influenca e profesorëve të mi shumë të nderuar dhe i ndikuar nga forca e gravitetit të tyre akademik kam ndjekur harkun e kësaj “parabole” sa artistike aq edhe shkencore. Ashtu sikur të gjitha parabolat janë të ngjashme në aspektin matematik edhe krijuesit kanë tipare të përafërta në kuptimin letrar. Ndaj forca stisë e një çmimi për shkrimtarët i nënshtrohet një formule kufizuese të ngjashme me lidhjet që ka parabola me ekuacionin kuadratik.

**Kurse krahasimi i këtij nderimi me e një hiperbolë letrare ka të bëjë me faktin se çmimi vjen nga Kompania Mediatike dhe e Botimeve “Nacional Grup” ku përfshihet edhe gazeta prestigjioze Nacional. Ai vjen nga vendi im, nga kolegët dhe miqtë e mi. Ky aspekt i çmim-**

**it ka vlera supreme për mua.** Nëse jam i sinqertë me ju dhe lexuesin e kësaj interviste, e ndjej edhe faktin se hiperbolë, në përkufizimin më të saktë të fjalës si figurë letrare, do të thotë “zmadhim”. Edhe nëse kjo fjalë është e aplikueshme këtu, mendoj se në këtë rast është e ligjshme, sepse është pjesë e natyrës së çmimeve letrare. Ndryshe çmimi do të individualizohet, pra do tkurrej në një çmim vetjak; vetëm për mua dhe përmasat e mia si krijues i Protonizmit. Këtë nuk do e shijoj me ndërgjegje të plotë, sepse këtë çmim e ndaj me të gjithë profesorët, me të gjithë kolegët dhe me të gjithë miqtë dhe shokët që më kanë ndihmuar gjatë punës time me Protonizmin.

**MB:** Megjithëse e keni bërë të qartë në hyrjen e librit, a mund ta përkufizoni edhe një herë Protonizmin për ata lexues të gazetës “Nacional” të cilët akoma nuk kanë gjetur rastin ta sigurojnë një ekzemplar të librit në fjalë?

**GJM:** Me kënaqësi. Protonizmi si perceptim lingvistik e përshtatje terminologjike është bazuar në linjat shkencore të kimisë dhe fizikës, më saktë në fjalën Proton që si pjesë përbërëse e bërthamës së atomit ka ngarkesë elektrike pozitive +1. Protonizëm, në kuptimin më të thjeshtë, do të thotë të shkruash rreth një veprë letrare apo artistike me qëllim pozitiv, i shtyrë nga dashamirësia jo nga vleri. Në nivele më të thella letrare, natyrisht, Protonizmi është interpretimi i hipotezës të së njohurës në kuptimin metafizik dhe i të njohurës jo deri në fund në kuptimin filozofik. Ai është pjesë esenciale e parametrave të etikës, dhe shërben si orientim që i besojmë tek ndërmarrim udhëtime instiktive apo të menduara drejt sferave të së vërtetës objektive në letërsi dhe art.

**MB:** A ka principe filozofike kjo teori. Nëse po, cilat janë ato?

**GJM:** Megjithëse kapaciteti hapësinor i kësaj interviste nuk është në balancë me potencialin e dinamikës interpretive që ofron Protonizmi, po mundohem t’i kondensoj të pesë principet në pesë paragrafë sa më koherent që të jetë e mundur. Ato janë: e Vërteta, Huluntimi, Restitucioni, Protonizmiotika, dhe Etika.

Protonizmi pohon se e Vërteta në lidhje me ideologjinë letrare është një fenomen i përkohshëm dhe është subjekt për të ndryshuar në pajtim me strukturën sociale nga e cila është krijuar dhe me rrethanat epistemologjike në të cilat zhvillohet. Në këtë kuptim, një e vërtetë mund të zgjasë vetëm aq kohë sa zgjat besimtari i saj, sepse një e vërtetë e përhershme është praktikisht e pamundur ngaqë gjendet gjithmonë në prirje të përsosjes dhe zgjerimit të mëtejshëm. Ndër këto kushte ambivalente, gjysmë e vërteta apo e vërteta që nuk mund të vërtetohet apo mohohet plotësisht nga shkenca ka një shans më të mirë qëndrueshmërie ndaj përjetësisë se sa e vërteta që shtyhet nga njeriu apo koha që të besohet si e vërtetë absolute e përbashkët. Ne tentojmë ta besojmë diçka si të vërtetë, të paktën si të vërtetë të përkohshme, sidomos nëse ajo na lehtëson apo plotëson nevojat tona individuale apo kolektive në aspektin praktik, teorik ose shpirtëror.

Protonizmi thekson se Huluntimi letrar duhet të ketë kërkesa të prera për aftësitë të larta analitike. Teoria shkon më tej duke shtruar idenë se shuma e njohurive kontekstuale që një kritik letrar posedon është instrumentale sidomos në kuptimin se si analiza dhe vlerësimi letrar reflektohet prej tij në vetëdijjen e lexuesit. Nisur nga kjo, një verifikim formal i paanshëm për të përcaktuar faktet rrethore të secilës veprë letrare në shqyrtim është i domosdoshëm. Kritiku letrar duhet të jetë i vetëdijshëm për doktrinën metafizike që marrin jetë në një shoqëri dhe të konsiderojë ekuilibrimin e konkluzioneve të tij me kushtet aktuale dhe problemet reale të komuniteteve specifike letrare.

Si një substancë teorike që promovon mirëkuptim kundrejt përpjekjeve letrare dhe filozofike bashkëkohore dhe që paralelisht tenton fuqizimin e demokracisë sociale, arsimit bashkëkohor dhe progresit shkencor, Protonizmi sugjeron një shkrim të empirike të dispozitave filozofike për një Restitucion të pandërprerë kundrejt vlerave krijuese të letërsisë nga ana e kritikës letrare. Kritikët letrarë duhet të gjejnë mënyra për të pasqyruar qëllimet pozitive të autorëve në veprat e tyre përkatëse me të njëjtën mirënjohje, por pa kompromentuar moralin apo denigrimin e standardeve të profesionalizmit të tyre. Principi i Protonizmiotikës del me idenë se botëkuptimi kritik është gjithmonë një uarpë më e madhe dhe më të rëndësishme se subjekti për të cilin argumentohet. Por këto uarpa zakonisht përkthehen në imazhe kuptimplotë protonizmiotike vetëm kur filtrohen nga shijet e lexuesit. Ky princip mund të studiohet si një trup gjuhësor me disa njësi të veçanta që përbëhen prej

skicës së shenjave dhe kodeve të strukturës analitike të kritikut letrar. Pra, Protonizmiotika, e cila mund të përkufizohet si studim i rregullave që fuqizojnë fenomenet sociale, e drejton vëmendjen e lexuesit tek puna e kritikut për të analizuar fjalët kyçe në gjuhën e tij dhe që andej për të zbërthyer kodet që përbëjnë bazën e karakterit të tij profesional. Nëse arsyetimi i fituar çon drejt interpretimit negativ të kritikës, teoria sugjeron klasifikimin e saj, jo publik, si një material i pavlershëm dhe ndërprerjen e ecurisë së mëtejshme të atij diskursi.

Në orbitën filozofike botërore etika ka kuptime të ndryshme tek filozofët. Për motivet e Protonizmit, principi i Etikës përkufizon kodin moral të kritikut letrar që përbën thelbin më kolutik të teorisë. Përmasat e rëndësisë janë të këtuila, sepse pozicioni i kritikut kundrejt temës që trajton ka potencial inventiv në formimin ose deformimin e vizionit të lexuesit, sidomos atij të pa familjarizuar si duhet me subjektin që i ofrohet. Që andej, standardi moral i kritikut letrar kthehet në një bosht terminalitikut rreth të cilit mbështillen njëherësh si efektet qendrore ashtu edhe ato anësore të interpretimit.

**MB:** Ju e keni propozuar për miratim këtë Teori Letrare në Konferencën e Profesorëve të Letërsisë Botërore në Des Moines, Iowa që në dhjetor të vitit 2005. Por Protonizmi u njoh zyrtarisht vetëm në vitin 2011. Pse mori një kohë kaq të gjatë ky miratim?

**GJM:** Teoritë letrare dhe lëvizjet filozofike në Amerikë gjithmonë kanë qenë subjekt tek maturia e akademikëve dhe vonesa e burokratëve. Pragmatizmi, bie fjala, filloi në këtë vend si lëvizje filozofike që në shkurt të vitit 1870. Ajo që pat stresuar dukshëm themeluesit e kësaj lëvizjeje si Charles Sanders Peirce, William James, Chauncey Wright, e më vonë John Dewey e George Herbert Mead ishte fakti se përdorimi i parë në shtyp i fjalës Pragmatizëm u shënuar pas 28 vitesh, pra në vitin 1898. Rryma gazetareske Gazetaria e Re (The New Journalism), fushë që kishte si forcë graviteti emrat e mëdhenj si H.L. Mencken, John Dos Passos dhe Ernest Hemingway, kërkoi më se pesë vjet të merrte jetë. Teorisë Formalizmi i Ri, megjithëse kishte në qendër të saj akademikë si Frederick Feirstein dhe Kenneth Rexroth iu desh gati një dekadë të aprovohej. Vetëm Lëvizja Biografike, epiqendër e secilës ishin shkrimtarët amerikan të viteve 1950 dhe 1960 me në krye Jack Kerouac, Allen Ginsberg, William Burroughs, Charles Bukowski dhe shumë të tjerë, arriti të zyrtarizohej brenda 4 vjetësh. Kështu, mund të them se duke i kuptuar afinitetet akademike dhe procedurat administrative amerikane nuk prisja të aprovohej aq shpejt sa ç’u aprovua. Aq më tepër kur shumë teori letrare, rryma filozofike, e lëvizje artistike që ishin adaptuar më parë në Amerikë kishin ardhur me kohë nga grupe e emra shumë të fuqishëm të vendeve më me zë të letërsisë dhe artit evropian përfshi këtu, Marksizmin nga Rusia, impresionizmin nga Franca, Ekspresionizmin nga Gjermania, Feminizmin nga Anglia (me





Në foto: Gjekë Marinaj dhe Frederick Turner gjatë promovimit të librit

vonë mori jetë edhe në Amerikë) pa përmendur këtu Rilindjen Italiane, Mitologjizmin Grek etj. etj. Protonizmi vinte nga unë, një pedagog me origjinë shqiptare, emri i të cilit për shumicën dëgjohet për herë të parë. Them kështu, sepse ka qenë një vit më vonë, pasi revista letrare Sojourn më nderoi më Çmimin e Parë në Poezi, kur kam filluar të njihem sadopak në Amerikë. Që të mos e zgjas më tej, megjithëse mori aq gjatë sa thoni ju, unë jam shumë i lumtur që Protonizmi ka afinitetet e tij akademike, historike dhe gjeografike me Shqipërinë.

**MB:** Zoti Marinaj, ju keni dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në suksesin e gazetës Nacional me shumë kritika dhe studime të një niveli shumë të lartë akademik. Si e konsideroni rolin e gazetës Nacional në promovimin e letërsisë dhe kritikës bashkëkohore?

**GjM:** Gazeta Nacional është një fenomen immanent në kulturën bashkëkohore shqiptare. Ajo ka gjetur një mënyrë për të tendosur atë pjesë të humanizmit shqiptar që u tkurrur—më parë nga simptomat epileptike e vonë nga dhënia shpirt—e gazetës Drita. Me gjithë grabitizmin ideologjik që vuajti për dekada të tëra nën trysinë diktatoriale të asaj kohe, Gazeta Drita akoma është e pazëvendësueshme kur gjykojmë atributin e saj në kulturën tonë. Mbjaj mend një kohë kur mendoja se letërsia shqipe pa gazetën Drita po i ngjante një njeriut pas një verbimi akut që më parë i kishte parë materiet në formën dhe detajet reale dhe më vonë vetëm mund t'i imagjinojnë ndryshimet e tyre. Krijimi i gazetës Nacional ma ringjalli shpresën e rilindjes së një embleme nga e cila do reflektohej imazhi i orvatjeve të talenteve shqiptare për një letërsi të arriur. Unë pata kënaqësinë dhe nderin të jap kontributin tim në të mirë të kësaj nisme me vlera të mëdha mbarëkombëtare. **Sot gazeta Nacional mendoj se plotëson në mënyrë protonistike një pjesë të mirë të nevojave intelektuale dhe letrare të një kombi të tërë. Parë nga një këndvështrim i veçantë, Nacional është si një sofër nga ku mund të ushqehen me dije të vegjlit dhe të mëdhenjtë pa paragjykime. Kjo filozofi protonistike aplikohet edhe në aspektin e autorëve që botohen aty—emrat më të fuqishëm të letërsisë tonë mbarëkombëtare kompensojnë për deficitet që mund të shfaqin heraherës talentet e reja.** Asnjë shkrimtar në botë nuk ka lindur shkrimtar i madh. Ata janë rritur falë talentit dhe punës së tyre, por dikush ua ka shtrirë dorën për t'u ngjitur atje ku janë sot. Gazeta Nacional e bën këtë me ndershmërinë më të madhe. Ajo po bashkon duart e krijuesve të mëdhenj me ato të talenteve në rritje për të

ndërthurur një urë të qëndrueshme letrare për të gjithë. Pikërisht për këtë jam shumë krenar që jam dhe do të mbetëm pjesë e gazetës Nacional.

**MB:** Zoti Marinaj, siç dihet Ju keni ndërmjetësuar botimin e disa poetëve shqiptarë në SHBA, keni futur Kadarenë në programet universitare amerikane, keni botuar në anglisht bashkë me poetin e mirënjohur Frederik Turner studimin dhe përkthimin "Epika Gojore Shqiptare" që do të hyjë si tekst i rekomanduar universitar në vitin 2013, si dhe keni publikuar shumë kritika dhe studime për letërsinë bashkëkohore shqiptare në shtypin prestigjioz letrar të SHBA-ve. Po kështu keni përkthyer këto ditë dhe botuar në anglisht poetin Preç Zogaj, si dhe jeni duke vijuar me shumë pasion përkthimin dhe botimin në SHBA të poetëve tjerë shqiptarë. Në takimet që kam patur në SHBA me shumë profesorë të shquar universiteti, poetë dhe kritikë të njohur amerikanë ju kanë cilësuar si ambasador i letërsisë shqiptare në Amerikë. Si e përjetoni këtë përkufizim si Protonist që jeni?

**GjM:** Perspektiva e letërsisë dhe kulturës nuk duhet lënë kurrë në hije. Promovimet e penave tona janë indikator i shtimit të njohurive të reja në Amerikë. Letërsia jonë, në respektin cilësor, nuk është inferiore tek asnjë letërsi tjetër. Libri juaj, Mujë, Fitore e Padukshme, libri i Preç Zogajt Ngjarje në Tokë, edhe poezitë e Epikës tonë po priten nga lexuesi Amerikan me një dashamirësi që shtrihet përtej istilës së imagjinatës time. Kur i kushtuam një numër të veçantë të revistës Translation Review letërsisë shqipe, disa nga anëtarët e bordit të panjohur sa e si duhet me letërsinë tonë e quajtën atë një veprim lëmpatik. Pas leximit të materialeve dhe shitjes së plotë të revistës brenda muajit të parë të daljes nga shtypi ata e pranuan veten si të gabuar dhe na uruan për nismën duke e kuptuar se klasifikimi i letërsisë në fragmente të izoluar nuk është më urtësi. Kjo u provua edhe me hyrjen e Kadaresë në programet akademike. Disa studentë tashmë e konsiderojnë Kadarenë si një nga majat e të larta të letërsisë së sotme botërore. Vetëm dhjetorin që sapo kaloi u hodhën 11,134 firma në një propozim që studentët amerikan i bënë organizatës së Çmimit Nobel për të konsideruar Kadarenë si fitues të këtij çmimi për vitin 2012. Atë që unë e konsideroj si një nder që më bëjnë duke shijuar Kadarenë, studentët e konsiderojnë si një privilegj akademik për ta. Unë jam duke i ruajtur, të paktën në Kolegjin tim, esetë më të mira të studenteve për librin *Ura me Tri Harqe* të cilat besoj t'i botoj një ditë me të gjithë emrat e studentëve në kopertinë si autorë të librit (nëse procedurat akademike na lejojnë, kuptohet). Pra

çdo prezantim i letërsisë shqipe në Amerikë e ka theksuar nevojën për një letërsi të tillë në këtë vend, dhe për mua ky është një Protonizëm në vetvete.

**M.B:** Si e parashikon të ardhmen e Protonizmit, si dhe ndikimin e kësaj teorie të re në botën letrare artistike dhe më gjere?


**Gj.M:** Pyetje e vështirë për tu përgjigjur me përgjegjësi. Por nisur edhe nga puna që kam bërë, mbështetja që kam nga profesorët dhe specialistët e institucioneve të ndryshme, por mbi të gjitha nisur nga noririteti pozitiv që kanë teoria dhe filozofia e Protonizmit në vetvete, kam shpresë se Protonizmi do të mbetet pjesë e konsiderimeve aplikative të njerëzve që e duan artin dhe njerëzimin.

**MB:** Pas botimit të Protonizmit, çfarë do të presin së shpejti lexuesit tuaj të shumë në Shqipëri, por edhe në të gjitha hapësirat shqiptare?

**GjM:** Protonizmi po zhvillohet nga një teori letrare në një lëvizje filozofike amerikane. Ky proces okupon një pjesë të rëndësishme të kohës time. Përveç kësaj, kam disa projekte në dorë të cilat të paktën në nivelin personal i konsideroj shumë të rëndësishme. Për mua si protonist, projektet akademike dhe letrare janë esencë e vet-krijimit, dhe secili ka për detyrë, të paktën morale, të mundohet ta sistemojë fuqinë letrare në atë mënyrë që vetë krijuesit, sado të vegjël në numër, të nxjerrin në krye të grupeve të tyre individualitete me potenciale të fuqishme, vitale dhe dinamike. Unë nuk jam i interesuar për promovimin e elitës autoriale në veçanti, por edhe për fuqizimin e të gjithë krijuesve që punojnë me ndjenjën dhe mendimin se një ditë puna e tyre do të jetë instrumentale në përmirësimin e jetës të së gjithë racës njerëzore. Në këtë vorbull mbështillen shumë nga projektet e mia të së ardhmes.


Zoti Buçpapaj, me lejo që me këtë rast të falënderoj nga zemra Ju personalisht, personelin e Nacional Grup, redaksinë e gazetës Nacional dhe Jurinë e çmimit Albanian BookerMan për nderimin e madh që më keni bërë duke më dhënë këtë çmim. Uroj që të jem në gjendje ta justifikoj nderimin tuaj me punën time si një shërbyes i denjë, në çdo anë që të jetë e mundur, i kulturës tonë mbarëkombëtare.

**Intervistoi: Mujë Bucpapaj**




SUNG ACROSS THE SHOULDER

HEROIC POETRY OF ALYRIA



TRANSLATED, INTRODUCED AND INTRODUCED BY  
GJEKË MARINAJ AND FREDERICK TURNER



Adriatic Press



“Nacional”, gazetë e elitës gjithëshqiptare

# GAZETA “NACIONAL” PROMOVUESE E NJË LËVIZJEJE TË RE LETRARE si “Protonizmi”

“Kjo pra, është gazeta “Nacional”, që në Shqipëri, në Kosovë dhe rajon mbuloi zbraztësinë që lanë gazetat simotra: “Drita” në Tiranë dhe “Fjala” në Prishtinë. Andaj, nuk është për t’u çuditur kur pohoj se gazeta “Nacional” hap një portë të madhe në mesin e një kështjelle, ku nga njëra anë hyjnë vlerat nga Tirana në rrugëtimin e tyre për në Prishtinë dhe nga ana tjetër, ato nga Prishtina për në Tiranë. Pikërisht kjo ka bërë që lexuesit në Kosovë, ta presin ditën e hënë para kioskave ku shitet gazeta “Nacional”. Në Prishtinë është i njohur qoshku para Radio Kosovës ku shitësi Ibrahim Gashi me një dashamirësi pret dhe përcjell krijuesit (shkrimtarët) që kthejnë ta marrin “Nacionalin”. Madje, ky burrë nganjëherë e ndien veten ngushtë, kur me ndonjë rast vonohet kjo gazetë.”

Nga Shahbaze VISHAJ, Studiuose -Prishtinë

Gazeta javore, letrare, kulturore, politike “Nacional” (Tiranë) me plot gojën mund ta themi se përmbushë një kërkesë të rëndësishme të artit në përgjithësi në Shqipëri dhe në Kosovë. Edhe pse me moshë të re (sapo ka shkelur në vitin e katërt të botimit), kjo javore letrare e kulturore bëri për vete shtresa të gjera lexuesish të mirëfilltë, pra edhe krijuesish, ku publikojnë krijimet e tyre (shkrimet) nga fushat e ndryshme të artit në përgjithësi. Gjeografia krijuese që defilon nëpër faqet e kësaj gazete është e gjerë, është një hartë e përfaqësuar nga të gjitha llojet e krijimtarisë artistike: letërsi, muzikë, arte pamore, kritikë, shkencë, teatër, film, publicistikë e fusha dhe lloje të tjera të krijimtarisë, në radhë të parë nga bota shqiptare, e pastaj edhe nga ajo e përbotshme, apo siç quhet edhe botërore.

Duke shfletuar këta 131 numra të “Nationalit” sa u botuan deri më sot, lexuesi ballafaqohet me një zgjedhje dhe redakturë ku dominon një frymë e re që përshkon artet në përgjithësi kohëve të fundit, e kjo lëvizjeje e re letrare në botë njihet me emrin Protonizëm. Nisur nga kjo filozofi, gazeta “Nacional” afroi dhe afron përherë vlera të dëshmuara artistike, duke na përballur me të arriturat më kulmore në secilën fushë të artit veç e veç, pra duke u nisur gjithnjë nga vlerat pozitive që afron poezia apo proza, kritika apo studimi, opera apo baleti, drama në skenë apo filmi në celuloid, piktura në pëlhurë apo skulptura në bronz e deri të intervistat e përherëshme ku krijues të ndryshëm shprehin idetë dhe mendimet e veta për artin në përgjithësi.

Ky edhe është synimi i pozitizimit në art, ku nëpërmjet vlerave pozitive ta përvetësojë lexuesin, ta edukojë shijen e tij vërtet për vlera të dëshmuara, për vlera të shëndosha, në mënyrë që të krijohet një frymë e re pozitive e të vlerësuarit dhe të shijuarit të arteve të bukura. E “Nacional” ia ka arritur kësaj. Po, po! Ia ka arritur me sukses të plotë. Autorët që defilojnë nëpër faqet e kësaj gazete shtrihen nga të gjitha viset shqiptare: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Lugina e Preshevës dhe Diaspora. Pra, “Nacional” është gazetë gjithëshqiptare (jo e një grupi të ngushtë krijuesish e mendimesh dhe vlerësimesh për njëri-tjetrin), ku nëpërmjet të frymës protoniste mbillet cilësia, vlera, e bukura, e dashura... Kur them kështu, kam parasysh gjithë ato poezi e tregime të bukura, fragmente romanesh dhe reportazhe, vlerësimet për libra dhe ekspozita, qoftë me tematikë shqiptare, qoftë edhe botërore. Me këtë rast nuk po i përmend autorët e shumtë me emër dhe mbiemër, por vetëm paraqitjet e figurave dhe portreteve letrare të nobelistëve të letërsisë që prijnë në formimin e shijes së bukur, qoftë duke mbjell artin e vërtetë të leximit, qoftë duke interpretuar vlerat universale të artit në përgjithësi. Kjo pra, është gazeta “Nacional”, që në Shqipëri dhe në Kosovë mbuloi zbraztësinë që lanë gazetat simotra: “Drita” në Tiranë dhe “Fjala” në Prishtinë. Andaj, nuk është për t’u çuditur kur pohoj se gazeta “Nacional” hap një portë të madhe në mesin e një kështjelle, ku nga njëra anë hyjnë vlerat nga Tirana në rrugëtimin e tyre për në Prishtinë dhe nga ana tjetër, ato nga Prishtina për në Tiranë.

Pikërisht kjo ka bërë që lexuesit në Kosovë, ta presin ditën e hënë para kioskave ku shitet gazeta “Nacional”. Në Prishtinë është i njohur qoshku para Radio Kosovës ku shitësi Ibrahim Gashi me një dashamirësi pret dhe përcjell krijuesit (shkrimtarët) që kthejnë ta marrin “Nationalin”. Madje, ky burrë nganjëherë e ndien veten ngushtë, kur me ndonjë rast vonohet kjo gazetë. Kjo që po them nuk është ndonjë kurtuazi, por një dëshmi vlerash që brumos në vete gazeta “Nacional”, që lexuesit i bartë nga java në javë në udhëtimin drejt panteonit të artit dhe vlerave protoniste që brumosin faqet e “Nationalit”. Këtë mund ta bëjë një gazetë dhe stafi i saj redaktorial pa paragjykime, pa dallime “krijues të mirë” dhe “krijues të këqij”; të këtij apo atij regjioni, të këtij apo atij grupi që mendojnë ndryshe nga çarqe e rrethe të caktuara. Falë Zotit, në letërsinë shqiptare, ka mjaft krijues duke filluar nga tradita, Rilindja apo letërsia në mes dy luftërave botërore, e pse jo edhe letërsia e fundshekullit të kaluar dhe të këtij fillimshekulli, ku dominojnë vlera të mirëfillta, që pasurojnë letërsinë tonë në përgjithësi me vlera universale. Për fund, duhet të pohoj me plot gojën dhe ndihem e nderuar të them dy-tri fjalë a mendime për gazetën “Nacional”, pikërisht për numrin e ri të kësaj gazete, që i kushtohet një krijuesi të mirëfilltë, siç është Gjekë Marinaj, i cili në faqet e kësaj gazete solli (poezi, kritika dhe shkrime të tjera) me këmbëngulje një frymë të re të filozofisë protoniste në letërsi. Si promovues i kësaj lëvizjeje të re letrare në botë, e edhe te lexuesit shqiptarë. Kjo frymë e re e njohur me termin



Protonizëm, shpresoj se do të shpërndahet gjithkah, ashtu si fryma (era) që ec nga lulja në lule, nga gjethi në gjeth, nga mendja në mendje, nga frymëzimi në frymëzim – duke u shndërruar kështu në një kopsht të vërtetë erërash aromatike që mbajnë në jetë njerëzimin dhe artin e së bukurës.


Shkrimtari dhe publicisti Sejdi BERISHA publikon historinë e teatrit të qytetit

## MONOGRAFIA “TEATRI I PEJËS”

Shkrimtari dhe publicisti, Sejdi Berisha, këto ditë botoi veprën e tij më të re, Monografinë “Teatri i Pejës”. Duke u mbështetur në faktin se Teatri i Pejës ishte vatra prej nga dolën aktorët më të njohur të Kosovës, të cilët pastaj, artin skenik e bënë madhështi përjetimi e loje artistike në Teatrin Kombëtar në Prishtinë (ish Teatri Popullor Krahinor) dhe më gjerë, ky krijues, tash e njëzetë vjet kishte ngulur këmbë që arritjet e artit skenik në Pejë por edhe aktorët që kontribuuan në këtë fushë, t’i përjetësojë në libër, dhe kështu, t’i hedh dritë vlerave shpirtërore dhe kulturore kombëtare, por, përmes kësaj, edhe vlerave dhe dëshmimeve historiografike nëpër periudha e decenie, të cilat janë një pasqyrë e rrallë dhe shumë e rëndësishme e të arriturave

kulturore në Pejë, Rrafshin e Dukagjinit, në Kosovë dhe të atyre kombëtare. Në këtë vepër janë sublimuar shumë të dhëna, dëshmi, argumente dhe vlera të artit skenik dhe jo vetëm të kësaj fushe, të cilat pasqyrojnë një punë me rëndësi shumëdimensionale kulturore, e që bindshëm përforcojnë dëshminë edhe përmes të mbi 240 fotografive dhe dokumenteve të tjera, që nga fillet e artit skenik në Pejë e deri në ditët e sotme. Veç kësaj, të dhënat e shtruara për shumë të arritura dhe për shumë artistë dhe figura të njohura të artit skenik, të letërsisë dhe përgjithësisht të kulturës, shtojnë peshën por edhe zgjojnë kërkësinë e lexuesit për të mësuar më shumë jo vetëm për historikun dhe rezultatet në sferën e artit skenik, por edhe për

të arriturat e të gjitha atyre figurave që sot e gjithë ditën i bëjnë nderë artit skenik, atij të film-it dhe të televizionit jo vetëm në Kosovë, siç janë: Melihate Ajeti, Istref Begolli, Ahmet Spahiu, Malo Gami, Kristë Berisha, Faruk Begolli, Ragip Loxha, Nuredin Loxha, Ramiz Loxha, Abdurrahman Shala, pastaj, Ilijaz Nushi, Ruzhdi Spahiu, Selami Taraku, Shaip Grabovci, Sejdi Berisha, Halil Gashi si dhe shumë e shumë të tjerë. Të gjithë këta por edhe figura të tjera të artit, skenës dhe të letërsisë, në mënyrë respektive janë prezantuar në monografinë “Teatri i Pejës”, në këtë libër-dokument me rëndësi, i cili provokon edhe për shkrime të tjera kërkimore dhe studimore edhe në lëmi tjera kulturore dhe historiografike.





Protonizmi: Roli pozitiv i kritikës letrare në letërsinë bashkëkohore Amerikane

# Protonizmi na inkurajon të gjejmë vlerat

*“Gjekë Marinaj ndërton teorinë e Protonizmit që rekomandon përqendrim në elementet pozitive të letërsisë që janë pjesë universale e ligjeve natyrale. Kjo teori është një teori e mençur dhe përshtatet mirë me kërkesat që vërejmë në kulturën letrare dhe historike Amerikane.”*

Nga Kristen M. Walker

*Duke parë drejt së ardhmes, zbatimi i teorisë së Protonizmit është një nga ecuritë më efektive për të siguruar një letërsi të vlerave të larta për dekadat që vijnë. Ngaqë letërsia luan shumë role në shoqëri, aty gjenden një varg i gjatë veprash që pëlqehen nga individë të ndryshëm, edhe nuk është vendi i kritikut letrarë të thonë se një vepër letrare është tërësisht e keqe, vetëm se ai vet nuk është pjesë e auditorit. Në të kundërt, kritikët duhet të identifikohen me ato rezonanca që janë në akord me idealet universale, të cilat mbështesin rolin e letërsisë për të zhvilluar njerëzimin.*



mit, ngjitur me atomet e tjera, liruar nën presion, dhe nganjëherë të shqyera tërësisht nga atomi. Karakteri esencial i atomit dhe pesha e tij atomike varet nga numri i protoneve dhe neutroneve në bërthamën e tij, dhe jo nga numri i elektroneve me ngarkesë elektrike negative.

Marinaj beson se thelbi i çdo veprë letrare, tamam si i çdo atomi, përbëhet nga elementet pozitive, apo protonet. Elementet negative janë të pafuqishme dhe më të vështira për t'i zotëruar për një kritikë letrarë. Në shumë raste, kritikët letrarë i bazojnë gjykimet ndaj pikave të dobëta të veprave letrare në fluturimet e interesave personale, preferencave vetjake, dhe opinioneve të tyre morale, të cilat nuk janë në akord me shijet e publikut. Kritikët gjithmonë do jenë në gjendje t'i identifikojnë gjërat që nuk u pëlqejnë në një vepër letrare.

Por kjo nuk duhet të jetë fokusi i kritikës letrare. Ndaj Marinaj ndërton teorinë e Protonizmit që rekomandon përqendrim në elementet pozitive të letërsisë që janë pjesë universale e ligjeve natyrale. Kjo teori është një teori e mençur dhe përshtatet mirë me kërkesat që vërejmë në kulturën letrare dhe historike Amerikane.

Në thellësi të saj, idealet e Amerikës përfshijnë dëshirën për të qenë një vend ku çdo kush mund të arrijë gjithçka. Ideja e Ëndrrës Amerikane është e pasur në pëlhurën historike, dhe njerëzit vijnë këtu duke ëndërruar se aftësitë e tyre, talenti dhe puna e palodhshme mund t'u sjellin atyre suksesin dhe sigurinë që dëshirojnë. Si një shembull i suksesit të Ëndrrës Amerikane, arrijtet letrare gjenden në zemër të librave historik Amerikan. Kushtetuta, Deklarimi i Pavarësisë, dhe Ligji i Mbrojtjes të së Drejtave të Njeriut janë të shfaqura me krenari në Arkivat Nacionale në Uashington, D.C. për të vënë në dukje fjalët e njerëzve që vijnë në këtë vend dhe janë të frymëzuar të përpiqen për suksese më të mëdha.

Protonizmi e mbështet Ëndrrën Amerikane sepse këmbëngul në gjetjen e vlerave në të gjitha veprat letrare. Rruga drejt suksesit gjithmonë kërkon përmirësim dhe punë të palodhshme, por është më e shtruar nëse kritikët letrarë japin përkrahjen e tyre duke skicuar idetë e tyre më të mira, ndërtimin mjeshtëror të fjalëve, dhe pikturionim e qartë të fjalëve.

Dokumente që na lanë themeluesit e letërsisë tonë nuk ishin draftet e para të tyre, por vepra të rishikuara disa herë në mënyrë kolektive që të theksonin idetë e tyre me të mira dhe të eliminonin ato që ishin të panevojshme. Në paraqitjen e

tyre finale, ato fjalë triumfuan si bazamenti udhëzues i këtij shteti që sot është një vend udhëheqës në botë, përkrah me vendet e tjera që janë njohur me qindra vjet më parë.

Madje që nga moshat e reja, studentët e universiteteve në Shtetet e Bashkuara mësojnë një lloj kritike letrare që është në akord me teorinë e Protonizmit. Pedagogët seleksionojnë vepra të letërsisë klasike që u kanë qendruar stuhive të kohës dhe i prezantojnë ato tek studentët si një mënyrë solide për të mësuar rreth leximeve, rreth artit dhe mjeshtërisë së tregimeve, dhe rreth zhvillimit të temave të të shkruarit. Studentët nuk sjellin lente subjektive të analizojnë çfarë nuk kanë pëlqyer rreth veprave të lexuara, por në të kundërt mësojnë rreth komponentëve universal të të shkruarit me efektivitet.

Madje edhe gjatë studimeve më të avancuara kur futen në thellësi të veprave jo edhe aq madhështore, studentët flasin akoma rreth librave në kuptimin e atyre që nuk kanë pëlqyer dhe jo rreth aspekteve që janë objektivist të një cilësie të ulët letrare. Protonizmi qendron sepse në thellësi të çdo veprë letrare mund të gjendet elemente pozitive, dhe këto janë esenca që ndihmon të mbijetojnë stuhitë e kohërave.

Gjatë ecurisë së studenteve në nivelet e studimeve të larta, ata ende kanë nevojë të përdorin Protonizëm që të mbështjellin këndvështrimet e tyre rreth letërsisë së vërtet dhe të bëhen shkrimtarë më të fuqishëm për veten e tyre. Ata mësojnë duke identifikuar së çfarë është efektive, duke studiuar mjeshtëritë e vërtet, dhe duke praktikuar përdorimin e teknikave të tyre të provuara për përmirësimin e cilësisë së shkrimeve të veta.

Madje edhe tek kritikët letrarë midis vetë kritikëve të letërsisë, fokusi vendoset në atë që shkrimtarët punojnë cilësisht dhe në pjesët që rezonojnë me korpusin e letërsisë. Ata i lënë shkrimtarët të redaktojnë apo rishkruajnë pjesët që nuk u përgjigjen normave akademike. Përqendrimi në aspektet pozitive i motivon shkrimtarët të krijojnë letërsi që vërtet ndikon fuqishëm tek lexuesi dhe vazhdon të zhvilloi kulturën tonë në kahe pozitive.

Duke parë drejt së ardhmes, zbatimi i teorisë së Protonizmit është një nga ecuritë më efektive për të siguruar një letërsi të vlerave të larta për dekadat që vijnë.

Ngaqë letërsia luan shumë role në shoqëri, aty gjenden një varg i gjatë veprash që pëlqehen nga individë të ndryshëm, edhe nuk është vendi i kritikut letrarë të thonë se një vepër letrare është tërësisht e keqe, vetëm se ai vet nuk është pjesë e auditorit. Në të kundërt, kritikët duhet të identifikohen me ato rezonanca që janë në akord me idealet universale, të cilat mbështesin rolin e letërsisë për të zhvilluar njerëzimin.

Protonizmi është veçanërisht i rëndësishëm kur shohim pozicionin e të shkruarit në botën bashkëkohore. Kultura e sotme e lehtëson aspektin e dëshirës për t'u bërë shkrimtar më shumë se në çdo pikë kohore të historisë.

Me rritjen e lexuesve elektronik (e-readers) dhe librave elektronik (e-books) kushdo mund të botojë një libër pa shpenzime dhe për ta

vënë atë në shërbim të kujtudo për shkarkim elektronik (download). Kjo është e vlershme sepse i lejon shkrimtarët të krijojnë ide për t'i adresuar librat tek kushdo që është i interesuar. Megjithëse shumica e librave elektronik nuk do jenë në nivelin artistik të librave të botuar nga shtëpitë e mëdha botuese, ato gjithsesi kanë vlera. Protonizmi ndikon shumë në të mirë të këtij soj botimi, sepse bëhet avokat i të kërkuarit të vlerave në këtë letërsi. Çdo libër elektronik është i vlershëm për dikë, dhe duke u përqendruar në aspektet pozitive, ne si kulture mund të mbështesim procesin e hapjeve së ideve dhe ekspertizës midis njëri-tjetrit nëpërmes letërsisë.

Nëse do të ndjekim ndonjë një metodë që na e dekurajon Protonizmi dhe të shkruanim recensione të ashpra bazuar në shijet tona personale dhe opinionet e njëanshme, ne do e dëmtonim progresin e letërsisë së sotme.

Duke u ndalur vetëm në dobësi gjatë kritikës letrare krijojmë një mënyrë për të shkruajuar shkrimtarët që janë në formim e sipër dhe ndoshta për t'u ndalur hovin për të ecur përpara drejt krijimeve më të arrira. Ashtu si me sportet, muzikën, dhe të gjitha aftësitë e tjera, të shkruarit cilësor arrihet nëpërmes praktikës së vazhdueshme dhe përpjekjes se përhershme për të gjetur rrugë më të përshtatshme për shndërruar idetë në fjalë më të zgjedhura. Në Amerikën bashkëkohore, shumica e të shkruarit gjënë botimin, qoftë në portale, në libra elektronike, ose në revistat dhe gazetat e pafundme. Ne duhet të jemi më fisnikë kundrejt shkrimtarëve duke bërë recensione që i ndihmojnë në rrugën e tyre në kërkim të asaj që punon. Inkurajimi i shkrimtarëve fillestar nëpërmes teorisë së Protonizmit, pra përqendrimi në aspektet pozitive të punës së tyre është mënyra më e mirë për t'i ngritur ata tek potenciali i plotë që kanë.

Kontributi i çdo shkrimtari është i vlefshëm, në një anë a një tjetër, dhe Protonizmi na inkurajon t'i gjejmë ato vlera. Është sikur kritikë letrarë lexon çdo vepër letrare si një shkëmb të minuar mbi sipërfaqen e një mali të madh. Shumë shkëmbinjanë kanë qoshe të ashpra dhe dheu mund të mbulojë çfarë gjendet aty brenda, por është puna e kritikut ta gjej atë gur të çmuar aty në mes dhe të flasin rreth tij. Gurët e çmuar vijnë në shumë forma dhe madhësi, por si tërësi, janë ajo çfarë përbën identitetin tonë letrar si Amerikan.

Kritikët i zbulojnë këto perla dhe flasin rreth vetive të shkëlqyera që kanë, dhe jo për dheun që tret poshtë gjatë depërtimit të tyre për tek to.

Marinaj na e parashtroi krejt qartë këtë udhëzim në teorinë e tij të Protonizmit, ku të gjithë lexuesit, pavarësisht nëse janë kritikë profesional apo lexues të rastit, mund të përfitojnë nga trajnimi pozitiv në kritikën letrare.

*\*Ky shkrim është rezervuar për botim në numrin e ardhshëm të revistës letrare “Hemisphere: Visual Cultures of the Americas” dhe përkthehet me lejen e autores dhe të drejtorisë së Department of Art and Art History at the University of New Mexico (UNM). Licence: 45UNM32754.*

**Përktheu nga Anglishtja:  
Mujë Buçpapaj**



*Pse në Shqipëri nuk ishte aplikuar më parë teoria dhe filozofia e PROTONIZMIT*

# Gazeta Nacional dhe Marinaj themeluan Protonizmin

*Protonizmi, në fund të fundit, është një teori letrare që kërkon nga kritikët letrarë të bazohen në veprën e autorit dhe jo në reputacionin që ka ai falë rrethanave të ndryshme në favor apo disfavor të tij. A është i aplikuar sa duhet teoria dhe filozofia e Protonizmit në kritikën tonë në Shqipëri apo edhe në vendet e tjera shqiptare?*

Nga Mimoza Erebara

Mendoj se si përgjigje të kësaj pyetje, si fillim duhet të përcaktojmë a ka ekzistuar në letërsinë shqipe një kritikë e mirëfilltë letrare? Në këtë mënyrë vetëm sa e risjellim edhe njëherë debatin shumëvjeçar rreth kësaj çështjeje. Për fat të keq ende nuk është mbajtur një qëndrim zyrtar. Dhe kjo e ka shpjegimin e vet. Ka mendime dhe opinione të ndryshme por në mënyrë më të përmbledhur e njëkohësisht edhe më të përgjithshme mund të themi se dallohen qartazi dy drejtime: i pari, është qëndrimi i inspiruar dhe drejtuar nga ideologjia dhe në shërbim të saj; dhe i dyti: qëndrimi kritik ndaj veprave letrare pavarësisht kohës kur ato u krijuan. Nëse qëndrimi i parë në një farë mënyre e ka marrë përgjigjen nga vetë koha, duke u bërë pak nga pak i përjashtuar nga mendimi kritik serioz, ndryshon puna me qëndrimin e dytë, në të cilin bie në sy një element shumë interesant, ai i polemikës. E, pikërisht këtu qëndron edhe problemi i vërtetë me kritikën në letrat shqipe, sipas mendimit tim. Jemi përpara një faktit që shkruhet kritikë, por kjo në shumicën e rasteve është thjesht një evidentim i sforcuar vlerash të prishme, por të munguara. Por edhe shkrimeve kritike që kthehen në polemika mes dy a më shumë autorësh dhe kjo, jo për vlerat e vërteta të veprave në fjalë, por për qëndrime individuale të këtyre autorëve në lidhje me probleme të ndry-

shme që shqetësojnë shoqërinë shqiptare. Aq shumë tërhiqen shkruarit e këtyre teksteve nga shkrimi i tyre, sa harrojnë edhe vetë thelbin e qëllimit të ekzistencës së kritikës letrare si të tillë! Ka edhe një qëndrim të tretë (të rëndësishëm-sipas meje [M.E.],) ai i kërkit të vërtetë shkencor në rrugën e të cilit studiuesit e kritikës eksperimentojnë, hulumtojnë, japin përfundime, evidentojnë fenomene letrare e risi procedesh artistike, venë në ballancë pikëpamjet e ndryshme filozofike dhe estetike të autorëve. Sigurisht që marrja e informacionit më të gjerë dhe dëshira për të qenë në lartësinë e mendimit botëror të kritikës letrare bën që shumë nga kritikët të kërkojnë me ngulm edhe rrugën më të mirë për ta, për të arritur deri tek përfundimet e duhura. Kjo do të thotë që kemi një laryshi interpretimesh rreth veprave apo dukurive letrare dhe përpjekje për të respektuar disiplinën shkencore. Kjo laryshi sigurisht që ka anën e saj të mirë por nga ana tjetër tregon që kjo kritikë në këtë kohë dhe në këto nivele nuk e ka gjetur ende një rrugë të vetme. Kjo në fakt edhe duhet kuptuar mirë. Nuk e kam fjalën për një unifikim të saj. Jo! Ne sapo kemi dalë nga një unifikim vlerash dhe nuk mund të bëjmë përsëri të njëjtin gabim. Bëhet fjalë për metodologjinë që duhet ndjekur në raport me vlerësimin dhe kuptimin e një veprë letrare dhe kjo pastaj të na

çojë vetiu në rrugë të ndryshme por që finalizohen prej një qëllimi. Në se vazhdojmë me kërkime të këtij niveli me këtë mënyrë ne pranojmë paaftësinë tonë për të qenë më vizionarë për të ardhmen e vlerave të letërsisë sonë. Nisur edhe nga kjo tablo e shkurtër, mendoj se në Shqipëri nuk është aplikuar teoria dhe filozofia e PROTONIZMIT në kritikën letrare (ndoshta me ndonjë përjashtim të veçantë!) Jemi dëshmitarë të ekspansionit mediatic kundrejt vlerave të shkruarve politikanë, për t'ju veshur atyre edhe rroba që nuk u bëjnë e nuk janë për ta. Thjesht nisur nga reputacioni politik që ata gëzojnë në shoqërinë shqiptare. Botimet e paraqitura në Panairin e fundvitit të kaluar e vërtetojnë më së miri këtë gjë. Dhe kjo nuk është hera e parë... Është e tepërt të theksojmë një për një argumentet që tregojnë se çfarë dëmi të madh krijon një "kritikë" e tillë në mendjet, informimin dhe edukimin e publikut, sidomos atij të ri. E nëse do të ishte aplikuar gjerësisht kjo teori dhe filozofi në të kuptuarit dhe të vlerësuarit të veprave sigurisht që do të kishim një tablo krejt tjetër. Edhe nëse autori do të ishte një figurë e njohur publike, ajo përkatësi nuk do e dëmtonte aspak imazhin e tij si krijues i mirëfilltë. Dhe mbi të gjitha do të pranohej si i tillë në komunitetin e letrarëve, do të shmangeshin polemikat patologjike e të panevojshme, veprës do t'i jepej



vendi që i takon. Metodologjia që buron prej filozofisë dhe teorisë së Protonizmit e mundëson një qëndrim të tillë, e bën letërsinë më të "kapshtme" edhe prej një lexuesi profan, po ashtu edhe prej një studiuesi të mirëfilltë të letërsisë, e sigurisht, prej një kritiku serioz. Gjithashtu do të kishim më shumë përfundime rreth vlerave të veprave letrare dhe do të ishim kësaj më të qartë në mendimin tonë për të përgjithësuar dukuritë e ndryshme letrare dhe për të përcaktuar risitë, drejtimet, për të definuar nëse kemi fenomen letrar apo jo. Gjë që padyshim letërsia dhe lexuesi e presin ta dëgjojnë pikërisht nga -kritika!

*Protonizmi ekziton në të gjitha kritikët dhe studimet e gazetës NACIONAL*

## MARINAJ – NJE MENDJE E ZGJATUR MES DY KONTINENTESH

*"Visarët e mendimeve të z. Marinaj janë të dala nga mendja e pajisur me dituri shumështrësore, siç është shumështrësore një nëntokë e pasur me gurët më të vlerë e më rrezatues në gjirin e saj."*


Nga Zymber Elshani

Në mendjen time përsaora u formësua përfytyrimi: Kroi i parë me ujë bilur ku z. Marinaj si fëmijë e i ri thëthiti sherbetin e diturisë ishte vendlindja – Malësia e Madhe, Shqipëria; më vonë gjeti kroin tjetër të diturisë larg vendlindjes, matanë oqeanit, në Amerikë, në Universitetin e Teksasit në Dallas. Nga librat kisha lexuar se ylberi kur shpaloset në qiell me dy skajet e tij shpesh ndodh t'i vë buzët në dy kroje (edhe po qenë larg) dhe ashtu pi e i ushqen ngjyrat e tij. Përnjëherë se si m'u duk se vepra e z. Marinaj dhe ai vetë ishte një mendje e hark ylberor i zgjatur mes dy kontinentesh. Si fëmijë kishte shijuar sherbetin e diturisë në kroin e vendlindjes, si i rritur gjeti kroin tjetër edhe më të begatë me nektar diturie të ëmbël mjaltë larg atdheut. Njëherë hark ylberi po shkëlqente mendja e ndritur e z. Marinaj.

Diturinë e thëthitur në kroin e vendlindjes e përcillte te kroi i vendit tjetër të largët, diturinë e ëmbël mjaltë të vendit në anën tjetër të globit e sillte në vendlindje. Ishte bërë ambasador i përcjelljes së ëmbëlsive e diturive të dy vendeve tanimë të bëra mike. Kishte gjetur çastin e ndritshëm të fjalëve. Po hynte në zemrën e artit me ngarkesën pozitive në mendje dhe shpirt. Këtë e vëren po e lexove vetëm një apo dy kritika e studime letrare të tij. Këtë e vura re edhe vetë sidomos muajt e fundit, kur lexova kritikën e studimet e tij të arrira në faqet e revistës NACIONAL. Fjala e tij të magjeps. Gjuha e tij është e kulluar. Dëshiron ta lexosh njëherë, dy herë, më shumë herë. Ta lexosh për shtatë palë qejfe, siç thuhet. T'i thurësh lavde. Ta përgëzosh.

Visarët e mendimeve të z. Marinaj janë të dala nga mendja e pajisur me dituri shumështrësore, siç është shumështrësore një nëntokë e pasur me gurët më të vlerë e më rrezatues në gjirin e saj. Përsëritës z. Marinaj dhe i urojmë suksese edhe më të mëdha në të ardhmen. Nga një djalosh plot fantazi në vendlindje, të vazhdojë të ndërtojë personalitetin e tij si erudit dhe njeri i akademive e mediave letrare më prestigjioze si në anën tjetër të globit ashtu edhe tek ne. Harku ylberor i mendimit magjepsës të tij qoftë vezullimtar e ngjyrë ndezur edhe për shumë vite. Dhe i stisur me dashamirësinë e energjisë dhe ngarkesës më pozitive.

(Prishtinë, më 12 janar 2012 )






Si mund të implimentohet Protonizmi në trajtimin e aspekteve historike dhe politike?

# Marinaj një pasurues i lingusitikës së kritikës botërore

“Protonizmi në politikë duhet të zë një vend të rëndësishëm. Çdo politikan duhet të ketë në vetvete sadopak Protonizem. Gjë që, fatkeqësisht te një pjesë e mirë e politikës shqiptare mungon dhe sidomos tek ata ligjvënës.”

Nga Vjollca TYTYNI



Shkrimtari, përkthyesi dhe studiuesi shqiptarë, Gjekë Marinaj, hyri natyrshëm dhe shprehu në letrat shqiptare mendimin e tij të përparuar kritik. Krijimtaria e tij letrare, poetike e studimore, flet bukur, qartë dhe kuptueshëm. Ndonëse i vonë në këtë fushë, letërsisë sonë i ka sjellur një pasuri të artë letare, e cila e bën Marinajn, një kritik të mprehtë dhe të talentuar. Duke e sjellur dhe përparuar në letërsinë shqipe dhe atë botërore, teorinë letrare të Protonizmit, kjo drejtëpërdrejtë e bën atë një njeri human dhe pasurues të lingusitikës shqiptare dhe botërore. **Në këtë arenë letrare protonizmi i Gjekë është një amalgamë tipike njerëzore e humane, ku pa asnjë paragjykim shpreh botën e sinqertë, që u transmeton njerëzve ngrohtësi dhe dashuri për të bukurën, duke emetuar vazhdimisht energji pozitive, nxitëse për të talentuarit e artit dhe letërsisë, për ata, që me përkushtim dhe pa mëri, provojnë t'i ngjiten kësaj gjinie të bukur letrare.**

Shtrirja e Protonizmit në mjedisin tonë Duke e parë këtë teori në këndvështrimin pozitiv, është e qartë se Protonizmi është një shërbyes i denjë i gjithë njerëzimit. Dhe jo vetëm në fushën e artit dhe letërsisë, por edhe në fushën ekonomike, sociale, e poashtu edhe në atë politike. Protonizmi, në rang global do të shërbejë për më shumë energji pozitive në drejtim të bashkimit të kombeve dhe të dhënjes fund të luftërave, për më shumë paqe në botë, për dashuri më shumë, për t'i dhënë fund urrejtjes ndër-njerëzore. Evidenca e kësaj energjie pozitive, gjithçka do të kishte zgjidhur me marrëveshje dhe paqe dhe nuk duhej të ishin marrë me mijëra jetë njerëzish në gjithë botën.

Letërsia jonë me dhe pa Protonizëm Referuar studimit të Protonizmit të prof. Gjekë Marinajt, mësojmë se: “Protonistët veprojnë apo reagojnë drejt letërsisë me ngarkesa të mjaft-

tueshme “elektrike” të karakterit pozitiv sa të mbajnë në ekuilibër apo të barazojnë numrin e “ngarkesave” negative të “elektroneve”. Gjithashtu është shumë domethënëse dhe tejet e rëndësishme se tek Protonistët, mbizotëron thelbi njerëzor, shpirti human, dëshira për të inkurajuar të tjerët, për të dalluar vetëm të bukurën në gjithçka e në këdo, pra mbizotëron ajo pjesë e shkrimtarit që e ka bërë botën letrare kaq moderne sa ç’ e kemi sot.”

Studiuesi dhe përkthyesi Marinaj, nuk do të thotë që nuk i vëren edhe gjërat negative. Ai e sheh atë që është dhe s’është e drejtë, e bukur dhe jo aq, e këndshme dhe jo aq, e shëmtuar apo jo... Ai e di se, kjo botë është humëgjyreshe dhe kjo gjë nuk mund të anashkalohet. Si një tipar njerëzor kërkon që gjërat të mund t’i marrim dhe t’i sjellim natyrshëm duke i ndërtuar dhe gjetur mënyrat më të bukura, që edhe ato të mund të frymojnë natyrshëm. Kjo na bën të shpresojmë për anoncimin e vlerave të mirëfillta. Të parandalohet dhe të mos ndillet vlerë për atë që është dhe quajmë art. Të ruhet arkitektura e zanafillës së krijimtarisë së bukur artistike e letrare. **Pra, Protonizmi zë një vend të rëndësishëm në fushën e letërsisë. Andaj, edhe trajtimi i kësaj teorie letrare dhe gjithashtu edhe vënja në praktikë nga krijues, analistë, shkencëtarë dhe studiues, ndihmon në zbehjen, mbasë, edhe në eliminimin e përdorimit apo të mohimit të qëllimshëm të vlerave, që shpeshherë bëhen për arsye dhe interesa personale.**

Domosdoshmëria e Protonizmit në politikë Protonizmi në politikë duhet të zë një vend të rëndësishëm. Çdo politikan duhet të ketë në vetvete sadopak Protonizem. Gjë që, fatkeqësisht te një pjesë e mirë e politikës shqiptare mungon dhe sidomos tek ata ligjvënës. Kjo mungesë ka bërë që të kundërshtohen dhe të mos miratohen shumë vendime dhe projektligje të rëndësishme, në Parlamentin shqiptar, e cila ka ndikuar edhe në mospranimin e Shqipërisë në BE. Pra, gjithçka ka ardhur thjeshtë nga mungesa e protonizmit. Kjo konfirmohet shumë qartë edhe nga fjala e kryetares së Parlamentit, Jozefina Topalli. Në seancën e parë parlamentare të këtij viti, që u mbajt me rastin e përgatitjeve për festimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ajo thirri për bashkëpunimi dhe angazhim të opozitës. Ndërlidhur me këtë ajo u shpreh se “disa ligje kërkojnë votën e opozitës. Pa këtë votë, ato nuk miratohen. Pa votën e opozitës disa kushte të integritetit nuk përmbushen. Ne duhet të përmbushim detyrat tona. Ne duhet të votojmë për to, të gjithë bashkë”. Prapa këtij fjalimi, a nuk shihet qartë mungesa e Protonizmit dhe e humanizmit, nga ana e opozitës? Qëndruar akoma tek Parlamenti shqiptar, konstatojmë se, kur ka Protonizëm, arrihet ajo që kërkohet në të mirë të të gjithë shqiptarëve, po gjithashtu kur nuk ka Protonizëm dhe vullnet politik, atëherë, nuk miratohen ligjet e rëndësishme që kërkojnë shumicë votash. 17 janari i 2012-ës, ishte shumë domethënëse! Ky parlament, na riktheu edhe njëherësh 28 nëntor-

in e 100-viteve më parë, ku ishin mbledhur burra të shquar të të gjitha trevave shqiptare, për t’i dhënë fund njëherë e përgjithmonë regjimit dhe pushtimit nga pushtuesit e huaj. Emcionuese, gjithashtu ishte edhe deklarata e deputetit të Parlamentit të Maqedonisë, z. Xhevat Ademi. “Më shumë se kurdoherë ne shqiptarët sot kemi nevojë për simbolikën”. Ndërlidhur me këtë, themi se kjo është edhe një thirrje tjetër, që përbën angazhimin dhe solidarizimin e përbashkët kombëtar, në ruajtjen dhe trajtimin e dinjitetshëm të ngjarjeve të rëndësishme historike. Mos vështrimin nga larg të ngjarjeve thelbësore, por veprimin e duhur e normal të politikës shqiptare. Intelektualët, të jenë uvertyrë e gjallë e (para)ndalimit të ndikimeve dhe ngacmimeve tendencioze, që janë të zakonshme nga politika serbe dhe greke me qëllim tëfshesjes dhe hedhjes baltë mbi çështjen dhe identitetin e kombit shqiptarë. Duke u ndalur tek logoja që simbolizonte bashkimin kombëtar, deputeti Ademi, vuri në pah interesin e komisionit përkatës të Ministrisë së Kulturës... së Shqipërisë, për shpalljen e fituesit të projektit madhor me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Miratimi i emblemës, që stilizon shqiponjën në formën e një flake jubilarë që i përngjan një trofeu, pasqyron gjithashtu trugun e vjetër të Shqipërisë së madhe, me gjymtyrët e saj të coptuara: Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, Çamërinë dhe të gjitha trojet shqiptare.

Duke shprehur dëshirën e përbashkët të idealit kombëtar, ai më tutje ka vazhduar “Nëse 17 janari në historinë tonë është ditë e tragjedisë, është ditë e dhimbjes, është vdekja e heroit legjendar, Gjergj Kastriot Skënderbeut, është vrasja e të madhit Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, në atë që fillojmë sot këtu në Tiranë, nën përkujdesjen e zonjës Topalli, me atë që fillojmë sot në Prishtinë, dhe me atë që sot fillojmë në Shkup, këtë 17 janar e shndërrojmë në ditë feste. E fillojmë si ditë shënimi të qenësisë sonë si shtet e si komb”. Ishte fjala e deputetit të Maqedonisë, z. Xhevat Ademi. E potencova qëllimisht këtë deklaratë për të nënvizuar simbolikën e kësaj ngjarje të rëndësishme historike për mbarë kombin shqiptarë dhe solidarizimin e të gjitha trojeve në pjesëmarrjen dhe shënimin sa më të mirë të këtij 100-vjetori të shtetësisë shqiptare. Të këtij 100-vjetori, pavarësi dhe të 100-viteve Shqipëri. Ndërlidhur me atë se, Protonizmi sugjeron një intensitet në rritje kundrejt përpjekjeve tona për të shqyrtuar, artikulluar dhe harmonizuar, një konglomerat idesh në ndihmë të esencës historike, kryeministri i Shqipërisë dr. Sali Berisha, në mënyrë krejtësisht të sinqertë, kërkoj nga shqiptarët bashkëpunim dhe unitet në realizimin e synimeve kombëtare e jetike. Ndërlidhur me këtë, ai ftoi shqiptarët që, në emër të këtyre sakrificave të mëdha, në emër të respektit të atyre që nuk panë një ditë të lirë, ndaj atyre që u flijuan për lirinë dhe dinjitetin tonë, të detyrimin të madh ndaj miqve tanë, le të bëjmë gjithçka, që të bëjmë çdo ditë e më shumë qytetarët shqiptarë, më të lirë, më të begatë, më



Vjollca Tytyni

të sigurtë, të bëjmë gjithçka për projektin tonë të madh, projektin e shqiptarëve në Evropë. Në këtë rrugë ne kemi arritje të mëdha, në këtë rrugë ne sërish kemi vështirësi reale, por e vërteta është që mundësitë tona, potencialet tona janë shumë e shumë herë më të mëdha se vështirësitë”. Më tutje, kryeministri Berisha, duke ju referuar kësaj ngjarjeje të rëndësishme uroi që “ky vit të jetë një vit i mbarë për shqiptarët, që viti i 100-vjetorit të Pavarësisë, të shndërrohet në vitin e rivlerësimit, e nderimit të madh për njerëzit tjerë, për të gjithë ata, të cilët kanë bërë të mundur këtë ditë, për miqtë tanë”. Shikuar përgjithësisht nga një vështrim kritik dhe moral, këtu nuk shohim frazeologji boshe dhe efekte sensacionale, për tërheqje të vëmendjes, por mu aty ishte vendi dhe momenti i duhur për të vepruar dhe thënë, sidomos në një moment të veçantë që kishte të bënte me 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, sepse realisht në atë fjalim qëndron parimi: “Asgjë s’mund të ndaj shpirtin e kombit” (citat i kryeministrit Berisha)... që ka vërtetë protonizëm (vullnet dhe energji pozitive). Dhe, deklarata tjetër e z. Berisha, e dhënë pas shpalljes së fituesit të logos zyrtare të kremtimit të 100 vjetorit, përçon mesazhin e bashkimit dhe për të kremtuar bashkarisht në këtë ditë dhe datë të shenjtë të nëntorit të pavarësisë. “E gjithë bota shqiptare duhet të bashkohet, edhe në Kosovë, Maqedoni dhe diasporë. Pavarësia nisi me Lidhjen e Prizrenit, në 1878 dhe përfundoi në 2008, me pavarësinë e Kosovës. Pa të, flamuri shqiptar në rastin e 100-vjetorit do të ishte në gjysmëshëtitë”. Sidoqoftë, Protonizmi i Gjekë-Marinajt le të shërbej si një ogur i mirë, jo vetëm për artin e kulturën, por mbi të gjitha për politikën shqiptare, që t’i thërrasin ndërgjegjes për dëshirën e mirë në marrjen e vendimeve të rëndësishme për popullin dhe kombin. Dhe, gjithnjë duke u mbështetur te protonizmi, detyrohemi moralisht për: Faleminderit z. Marinaj! Faleminderit “Nacional”! Keni mirënjohjen e shkrimtarëve, studiuesve, lexuesve dhe brezave që vijnë.




Kodifikimi i idealizmit absolut dhe i psikologjisë eksperimentale në veprën e John Dewey

# KRIJIMTARIA LINGUISTIKE E DEWEY-IT DHE PERFORMANCA E FILOZOFISË PRAGMATIKE

“Versioni i Dewey-it për natyralizmin, gjithsesi përmban një parim të diskutueshëm për të kufizuar dualizma të tilla si, mendja dhe materiali, fryma dhe natyra, pamja dhe realiteti. Për të shpjeguar këtë në mënyrë pragmatike, ai krijon rreshta pafund, që e konsiderojnë natyrën si fenomen organik dhe të vazhdueshëm. Ndërsa, synon të sqarojë ndërlidhjet e marrëdhënieve njerëzore në procesin e kërkimit të njohurisë nga përdorimi i arsyes dhe intuitës, veçanërisht arrijen dhe përdorimin e një gjuhe aq të pragmatizuar, ai e trajton situatën në mënyrë pragmatike në kontrast të plotë me filozofët e antikitetit të Greqisë, të cilët spekuluan me lidhjen tru/mendje. Gjuha pragmatike e Dewey-it mbështetet në iluminizmin e këtij fenomeni, i cili nevojitej që në kohën kur “as Platoni, as Aristoteli nuk e njihnin funksionin kryesor të trurit në perceptim, apo gjuhë. [Dhe pa] urtësinë e Aristotelit e rrëzoi atë, kur sugjeroi se, truri është si sfungjeri, funksioni i të cilit shërben për të qarkulluar gjakun. Megjithëse, shkrime të tjera në të njëjtën kohë dëshmojnë një depërtim më të thellë.”

Nga Gjekë MARINAJ



John Dewey mbetet një nga filozofët amerikan me famë mbarëbotërore dhe një nga psikologët më të vlerësuar. Ndikimi i tij në sistemin shkollor amerikan dhe në reformat sociale të këtij vendi është po aq i njohur sa dhe roli i tij si një nga etërit e pragmatizmit së bashku me Charles Sanders Peirce dhe William James. Megjithatë, krijimtarisë së Dewey-it mbi linguistikën dhe performancën pragmatike në filozofi akoma i mungon vlerësimi që vërtet meriton. Kjo ndoshta, sepse, që në krijimtarinë e hershme të tij praktikoi kodifikimin e idealizmit absolut dhe psikologjinë eksperimentale dhe se ka pasur të bëjë me një tranzicion gradual (i cili nisi në vitet 1890-të) ku vëmendja e tij u përqendrua në tendenca më praktike dhe empirike. Apo më keq akoma, në mundgësën e shkallës së duhur të vlerësimit ndaj tij në këtë pikë, mund të këtë ndikuar edhe ndonjë interpretim i pasaktë i pragmatizmit si ai i Bill Durant, i cili i kushtoi vëmendje kontributit gjuhësor të Dewey-it përmes pragmatizmit, por në përpjekje për ta mënjeluar domosdoshmërinë e pragmatizmit në përgjithësi si shkollë e filozofisë dhe jo për ta ndihmuar atë:

Mbi të gjitha pragmatizmi, nuk ishte “thjesht” filozofi amerikane; ai nuk ngërthente frymën e Amerikës më të madhe që shtrihet nga jugu dhe perëndimi i shteteve të Anglisë së Re. Ai

që jashtëzakonisht moralizues, aq sa e tradhtoi origjinën puritane të autorit. Ai nxori me një frymë përfundime praktike dhe probleme faktike dhe nga ana tjetër eci me vrullin e shpresës nga toka në qiell. Nisi me një reagim të fuqishëm kundër metafizikës dhe epistemologjisë, aq sa dikush priste nga ai një lloj filozofie të natyrës dhe shoqërisë, por që përfundoi thajse si një lutje ndjese për etikën intelektuale të çdo parimi të vyer. Pra, kur do të mësojë filozofia t’ia lërë fesë shqetësimet tronditëse të jetës tjetër dhe psikologjisë, ato vështirësitë e mëdha gjatë procesit të dijës dhe t’i japë vetvetes me gjithë forcën e saj, ndriçimin e qëllimit njerëzor, harmonizimin dhe kulmimin e jetës njerëzore? (Durant, 565).

Cilatdo qofshin arsyet, “gjuha është mjete i mjeteve, është nëna ushqyese e çdo esence” në filozofi (Dewey, NC, 58) dhe disfata qëndron në faktin se shumë pak studiues kanë marrë iniciativën të zbulojnë këtë aspekt të domosdoshëm të pragmatizmit të Dewey-it ashtu si e ka zbuluar edhe Emmanuel G. Mesthene. Në librin me titull “Si na sqaron gjuha” *How Language Makes Us Know*, Mesthene lidh tranzicionin e tij nga Aristoteli deri tek Dewey me këtë miratim: “Çfarë që përfshihet në tradhtinë ndaj pragmatizmit dhe ndaj konceptit më të ndërlidhur gjuhësor mbi të cilën do të duhej të mbështetej, solucionin do e gjejmë në kapitullin tjetër, në atë të Aristotelit të sotshëm [Dewey]” (Mesthane, 46). Mbështetur në këtë pikë, a pranojmë plotësisht Mesthane-in, por më tepër argumentin e Dewey-it në esenë “*Matriksi ekzistencial i analizës: kulturë*”, në të cilën argumentoi se “fusha origjinale e gjuhës apo simbolet mund të arrihen vetëm përmes përpjekjeve që sjellin një grup veprimtarish në kushte të pranueshme” dhe faktin se “qeniet njerëzore mendojnë kur kundërshtohen nga disa lloj problemesh” (Dewey, 84). Përmes këtyre rreshtave të kësaj eseje, dëshiroj të përshkruaj dhe vlerësoj, se si e përdori John Dewey krijimtarinë në linguistikë dhe performancën pragmatike, e cila e përkthyer në një gjuhë të unifikuar pragmatike i bëri edhe më të qarta disa nga tiparet më të përcaktuara të pragmatizmit, si p.sh, metodën e orientimit të problemeve përkundrejt dilemave praktike dhe intelektuale. Me fjalë më të thjeshta, Dewey përdori një gjuhë, që lidhet me tërë pikëpamjen konceptuale të filozofisë pragmatike.

Dewey botoi disa nga artikujt më me ndikim në dhjetëvjeçarën e fundit të shekullit të 19-të, ku stili i shkrimeve të tij pasqyroi simbole të nuancave pragmatike në lidhje me gjuhën. Dewey

zhvilloi më shumë teorinë e gjuhësisë dhe që atëherë natyra e këtyre shkrimeve u pasurua më tepër përmes kuadrin të plotë konceptual të asaj çka përbën plotësisht pragmatizmin. Gjuha e tij filloi të renditet nga prirje përkushtimi drejt reagimeve biologjike, jo si “diçka e gatshme, që njeriu e fantazonte për të shprehur mendimet dhe idetë” (Hook – Wienpah, 273). Pavarësisht nëse tema e trajtuar merrej me analizën e përvogave emocionale, apo ndërmerre diçka që kërkonte përpjekje të ngjashme me kalibrin e gjuhës së simboleve “Reflektim i konceptit harkor në Psikologji” *The Reflex Arc Concept in Psychology* që perceptimi gjuhësor i esencës strukturore pragmatike. Kjo ishte e “qartë se metoda e analizës së Dewey-it përbëhej nga kërkesa e analizës së efektshme, kushti i të cilit duhej të qartësohej dhe shqyrtohej, jo vetëm nga ana logjike, por edhe gjenetike e empirike” (Hook – Wienpahl, 273). Dewey zbatoi idenë kryesore, sepse synonte që t’i mendojmë fjalitë si diçka “prekëse”, “vizuale” dhe jo thjesht si metafora që kërkohet t’i bashkohen përgjysmë kulminacionit të mendimeve të tij. Stili gjuhësor dhe marrëdhënia me idetë pragmatike mendohej “të qenit i përjashtuar për të pasur ndikim të madh mbi rëndësinë e metodës filozofike dhe vlerën e saj me natyrë praktike” (Norton, 76).

Edhe pse ekzistonin akumulime hegeliane në mendimin e tij, vlen të vërejmë se, stili gjuhësor i Dewey-it nuk shfaq asnjëherë shembëllime hegeliane. Në të vërtetë ai zbuloi diçka tek Hegeli, që i ngjiti pas, sidomos për çështje në lidhje me arsimin, psikologjinë, politikën, lëvizjet sociale dhe darvinizmin, ndaj ia vlen të themi se pjesë e përbajtjes dhe interpretimit të mendimit të Hegelit për këto çështje u bë thajse lajtmotiv në shkrimet e Dewey-it gjatë gjithë krijimtarisë, por që asnjëherë nuk e modeloi krijimtarinë e tij gjuhësore me atë të Hegelit, apo me dikë tjetër. Mendimi se letërsia e shkruar dhe koncepti gjuhësor kanë gjasa të mbeten të strukturuar mbi modelin në të cilin e kanë prejardhjen dhe se gjuha “supozohet të jetë thjesht mjet të shprehuri apo komunikimi, do të thotë se ato përmbajnë ide apo kuptime të plota në vetvete, përveç forcës së përbashkët vepruese”, (Dewey, EM, 81) e cila ishte shumë më tepër e përshatshme dhe e zbatueshme nga pikëpamja pragmatike e filozofisë.

Në realitet ekziston një mosmarrëveshje universale midis studiuesve përsa i takon asaj se, sa shtresa të tilla akumulohen dhe ku gjenden ato. Është ende e vështirë të kuptohen disa pjesë nga vepra e tij pa menduar për to në lidhje me

filozofinë e Hegelit. Ndërkohë, pavarësisht mendimit të Dewey-it në sistemin natyralist të “organizimit dhe mjedisit”, fakti se nuk është e vërtetë sipas kuptimit linguistik (së paku për rastin e tij), mund të interpretohet në një argument të zbatueshëm se Dewey i vërtetoi vetëm pjesërisht të vërtetë disa nga linguistikët që mendonin se gjuhët përbëhen nga një “cikël jete” dhe u zhvilluan sipas ligjeve evolutive, pasi mendohej gjithashtu, se çdo gjuhë mund ta ketë prejardhjen nga një trashëgimtar i përbashkët. Mbi të gjitha, përveç faktit se kjo teori e natyralizmit biologjik mbart pjesë të një të vërtete brenda saj, ka të bëjë me një mbi thjeshtëzim se si ndryshojnë gjuhët dhe si mund të evoluojnë në gjuhë të tjera, apo në stile të shkruari si ajo e Dewey-it (Fromkin, Rodman, Hyams, 520). Gjuha e Dewey-it mbështetet në disa nga këto koncepte, por ajo mbetet unike në terma të të qenit në gjendje të përshtatet me pragmatizmin pa radikalizuar tërë strukturën. Ai nuk mendon sipas fjalëve të kohës, vetëm sepse përmes tyre historianët mund të përkufizojnë një epokë, apo të përcaktojnë një çast të humbur, për shkak se, “gjuha nuk rrjedh nga një asociacion idesh, por ia beh si shfaqje e natyrshme prej trajtave të mëparshme të botës shtazore, ajo reagon për të ndryshuar format dhe modelet e para me një veprimtari në lidhje të tillë si për t’i dhënë jetë një forme të re” (Dewey, EM, 86). Për pasojë, vetëm me shfrytëzimin e gjuhës së tij krijuese, Dewey nuk na jep një nivel të ri përjetese, por na transmeton shkrime pragmatike, pra një dimension historik në të njëjtën kohë.

Po të flasim nga ana pragmatike, Dewey e trajton botën si fenomen të zakonshëm dhe këmbëngul të veprorë njësoj me gjuhën përmes së cilës përshkruan. Për disa të tjerë, natyralizmi në filozofi nuk do të thotë thjesht supernatyralizëm. Filozofia natyrale nuk ka zot, apo fantazma, e të tjera si këto. Natyralistë të tjerë kanë një këndvështrim më të rreptë dhe flasin esencialisht se, nuk ekziston asnjë dije shkencore tek natyralizmi. Megjithatë, kjo nuk është e pazakontë në filozofi, “kur Aristoteli konfigurroi ndryshimin midis aspekteve të ndjeshme që janë më të dukshme, të njohura, racionale dhe më shumë evidente, që vet-njihen, ai po bënte dallimin midis gjërave që funksionojnë në universin e diskutit lokal të kufizuar dhe të tjera si këto, simbolet e të cilave janë të atilla, sa janë gati të krijojnë dialog të larmishëm dhe pambarrim” (Dewey, NC, 53).

Versioni i Dewey-it për natyralizmin, gjithsesi përmban një parim të diskutueshëm për të





Në foto: John Dewey

kufizuar dualizma të tilla si, mendja dhe materia-  
li, fryma dhe natyra, pamja dhe realiteti. Për të  
shpjeguar këtë në mënyrë pragmatike, ai krijon  
rreshta pafund, që e konsiderojnë natyrën si  
fenomen organik dhe të vazhdueshëm. Ndërsa,  
synon të sqarojë ndërlikimet e marrëdhënieve  
njerëzore në procesin e kërkimit të njohurisë nga  
përdorimi i arsyes dhe intuitës, veçanërisht ar-  
ritjen dhe përdorimin e një gjuhe aq të pragmati-  
zuar, ai e trajton situatën në mënyrë pragmatike  
në kontrast të plotë me filozofët e antikitetit të  
Greqisë, të cilët spekuluan me lidhjen tru/mend-  
je. Gjuha pragmatike e Dewey-it mbështetet në  
iluminizmin e këtij fenomeni, i cili nevojitej që në  
kohën kur “as Platoni, as Aristoteli nuk e njih-  
nin funksionin kryesor të trurit në perceptim,  
apo gjuhë. [Dhe pa] ertësinë e Aristotelit e rë-  
zoi atë, kur sugjeroi se, truri është si sfungjeri,  
funksioni i të cilit shërben për të qarkulluar  
gjakun. Megjithëse, shkrime të tjera në të njëjtën  
kohë dëshmojnë një depërtim më të thellë”,  
(Fromkin, Rodman, Hyams, 34).  
Nga ana tjetër, filozofia e Dewey-it u ndikua më  
shumë nga psikologjia, darvinizmi dhe sidomos  
biologjia. Përvoja njerëzore, sipas tij është një  
organizëm i përcaktuar në mjedis ku të dy  
gjenden në proces të vazhdueshëm ndërvepri-  
mi. Kjo pasi natyralizmi i tij synon përmirësimin  
e vijimësisë, ku gjithçka flet për mendjen e njeri-  
ut, mendimin njerëzor, arsimin dhe shkencën në  
filozofi, e cila duhet të ndërtohet mbi këtë imazh  
ndërveprimi. Megjithëse për Hare-in, sipas këtij  
sensi, së paku kuptimi i asaj që ai i quan fjalë-  
vlerore, “nuk është natyraliste, nuk rezulton në  
fjalë që shndërrohen në analitike, të cilat nuk  
janë të tilla në përdorimin e zakonshëm. Për më  
tepër dëshmon duke vendosur drejtësi të plotë,  
si në përshkrim dhe vlerësim; në elementet mbi  
kuptimin e fjalëve-vlerore dhe mënyrën se si  
veprohet me rolin që ato luajnë në përdorimin e  
zakonshëm” (Hare, 175).

Por, nga pikëpamja shkencore dhe linguistike,  
gjithmonë do të ekzistojë pyetja, se si do të ndry-  
shojë kapaciteti, mendja, mendimi dhe shkenca  
për të ndërvepruar më efektivisht me mjedisin?  
Po mirë, aspekti i darvinizmit mbi mbijetesën dhe  
kuptimësinë, mbetet veçanërisht i vërtetë për

një organizëm që është i aftë në gjendjen e ndje-  
sisë simbolike, pasi siç “pohuan filozofët, Gell-  
ner dhe Rusell, ndryshimet midis tyre me njerëz  
të panjohur duken të parëndësishme, torturat  
tradicionale të filozofisë, si për shembull, lidhja  
midis mendjes dhe trupit, lirisë dhe vullnetit,  
objektivitetit të vlerave dhe mundësisë së sh-  
kencës faktike jo empirike” (Michaels & Ricks –  
Tanner, 458). Vizioni parashikues i shkencës i  
jep jetë një tjetër dallimi, veçanërisht në epokën  
post-karteziane të mendjes dhe materies, si dhe  
një morie tjetër të dualizmave metafizike. Në një  
nga librat e tij epike në vitin 1938 “Logjika: teori  
e analizës”, gjendet një paragraf me titull “A  
është logjika disiplinë sociale?” përmes së cilës  
Dewey ndan pikëpamjet e tij nga ato të aka-  
demikëve të tjerë përfaqësues, ku “rëndësia më  
e kufizuar shprehet në lidhje me logjikën e sim-  
boleve. Ata që lidhen me ‘logjikën e simboleve’,  
jo gjithmonë e kuptojnë nevojën për të sjellë një  
imazh të referimit dhe funksionit të simboleve.  
Ndërsa, lidhja e simboleve me njëri - tjetrin është  
e rëndësishme, simbole të tilla duhet të kupto-  
hen si përfundim sipas funksionit për të cilin  
shërben simbolika” (Norton, 79).

Përkatesisht, eseja e tij e njohur “Reflektim i  
konceptit harkor në psikologji” mbetet një nga  
kritikat e hapura mbi idenë, pasi psikologjia është  
çështje stimuli dhe reagimi, sido të ndodhin pro-  
ceset ndërhyrëse midis tyre. Që të themi se jemi  
krijues në përdorimin e gjuhës, do të thotë se  
përdorimi i gjuhës nuk kufizohet me sjelljen  
stimul-reagim. Ndoshta Dewey do ta pranonte  
përmes kësaj. Por, këtu ekziston një analogji e  
lidhur me të, e krijuar nga tre linguistë të njohur  
amerikanë ku “është e vërtetë se, nëse dikush ju  
shkel këmbën, do të reagonit menjëherë përmes  
thirrjes, por këta tinguj nuk janë pjesë e gjuhës.  
Ato janë reagim i pavullnetshëm ndaj shkakut.  
Pasi thërrasim në mënyrë reflektive, mund të  
them, “faleminderit që ma shkele këmbën, pasi  
kështu kuptova se, nuk vuaj nga elefantizmi dhe  
meqë e ndjeva, tani e kuptoj më mirë se nuk e  
kam këtë sëmundje!” (Fromklin, Rodman,  
Hyams, 9). Ndërsa argumenti i Dewey-it qën-  
dron esencialisht se në të vërtetë nuk kalon  
thjesht në një proces që ngjan si hark, për shkak

se çdo reagim ndryshon ambientin me mënyrën  
se si krijon nxitje të tjera. Në thelb, mënyra me të  
cilën duhet ta kuptojmë mendjen është se mendja  
lidhet me një qark të pandërprerë të ndërvepri-  
meve. Stimujt dhe reagimet nuk janë marrëveshje  
të izoluar. Në mënyrë esenciale, “mendja është  
e integruar në një qark të pandërprerë të ndërve-  
primeve. Stimujt dhe reagimet nuk përbëjnë of-  
erta diskrete. Ideja përcakton lidhjen e kuptimit  
me gjuhën, e cila nuk ngatërrohet me nominal-  
izmin tradicional. Ajo nuk do të thotë se kuptimi  
dhe esenca janë të rastësishme dhe arbitrare.  
Faji i papërsosmërisë qëndron në harresën vir-  
tuale të komunikimit dhe shoqërisë.” (Dewey,  
NC, 57).

Dewey përsëri i respektoi me të vërtetë Platonin  
dhe Aristotelin për ndihmesën e dhënë në filoz-  
ofi, por edhe sepse i përkisnin një shtrese më të  
lartë aristokrate që e përshkruanin dijen me gju-  
hë meditative, e cila nuk ishte në përputhje me  
audiencën e tyre të përgjithshme, por mbësht-  
etej në përvojën e fituar sociale dhe historike.  
Vini re se fjala “përvojë” është kyçe, sidomos  
që kur kjo ese merret me gjuhën pragmatike të  
Dewey-it në lidhje me empirizmin e drejtpërdrejt  
që ende përdor emra të ndryshme që i trillon  
përmes krijimtarisë së Dewey-it. Botëkuptimi i  
tij ishte se “gjuha konsiderohej si ngjarje e për-  
jetuar që na mundëson të interpretojmë atë që  
ndodh në të vërtetë kur zbulohet dialogu racio-  
nal dhe logjik nga e shkuara dhe kur “përvoja” e  
brendshme dhe vëmendja e saj zbulohen nga  
modernistët. Gjuha është funksioni i zakonshëm  
i shoqërisë njerëzore dhe pasojat e saj reagojnë  
mbi ngjarje të tjera, fizike dhe humane duke u  
dhënë kuptim apo rëndësi” (Dewey, NP, 53). Kjo  
është një nga arsyet përse, zbatoi stilin gjuhës-  
or të Dewey-it, i cili rrallë herë kundërshtoi thel-  
bin e mendimeve të tij dhe kjo është më se e  
pandryshueshme nga pragmatizmi. Në këtë rast,  
gjuha nuk shërben thjesht si një mjet me të cilin  
mund të përshkruhet plotësisht një përvojë, por  
është edhe përvoja gjuhësore brenda aftësive  
të saj artistike për t’i bërë të qarta gjërat. Sikurse  
e përcakton edhe Audi, koncepti i Dewey-it mbi  
përvojën “lidhet përfundimisht me konceptin për  
natyrën. Ai e mbarsi natyrën si një sistem të  
avancuar të komunikimit të zakonshëm që pra-  
non dallimin tre-palësh midis nivelit psikokimik,  
psikofizik dhe atij të përvojës humane me idenë  
se ky kategorizim nuk interpretohet për të nënk-  
uptuar ndonjë mungesë të thellë logjike” (Audi,  
199). Gjithashtu për Dewey-in dhe Jams-in, nëse  
një fjali nuk parashikon përvojën, nuk konsid-  
erohet të jetë e vërtetë nga ana konceptuale.  
Kjo mbart një rëndësi të jashtëzakonshme, sepse  
sigurisht, gjuhët filozofike “ndryshojnë me kal-  
imin e kohës, por modeli i të shkruarit synon të  
jetë edhe më konservativ” (Fromkin, Rodman,  
Hyams 520). Ndërkohë ende, “ekziston një urë e  
zakonshme që lidh hapësirën midis ekzistencës  
dhe esencës; e cila do të thotë, komunikim, gju-  
hë dhe diskurs” (Dewey, NC, 51).

Ndërsa ekziston një ngjashmëri e çuditshme  
midis empirizmit të drejtpërdrejt dhe asaj që Uil-  
liam Xhejms e quajti empirizëm radikal, gjuha  
krijuese e Dewey-it është mjaft e përshtatshme  
të shpjegojë se ideja kryesore e empirizmit qën-  
dron në atë se gjithçka që është përvojë reale,  
është ajo që përjetohet. Sipas Dewey-it, përvo-  
ja mbetet haptazi si gjithmonë, pjesë e disa  
ndërveprimeve dhe përbën gjithë ndërveprimin  
dhe jo vetëm atë që luan me mendjet tona.  
Atëherë si del që gjuha e tij të jetë në veçanti  
pragmatike? Për fillestarët, fjalitë e tij sjellin për-  
fundime praktike në lidhje me garantimin e kup-  
timit të qartë të ideve. Dewey nuk mendon se  
interpretimi i mirë nuk përcakton thjesht me ras-  
te atë që duket. Sipas tij, interpretimi nuk duhet  
të shoqërohet me nxjerrjen e një sekretit, apo  
zgjidhjen e një misteri. Ai del nga mënyra e tij  
për t’i bërë të qarta idetë, duke përdorur shem-  
buj si ai i shkëputur nga “citimet e empirizmit të  
drejtpërdrejt”, ku flitet për ndryshimin e reali-  
tetit të jetuar të ndikuar përmes mjeteve njohëse.  
Kjo përbën linguistikën pragmatike të Dewey-

it. Këtu jepet një shembull i veçantë i zbatimit të  
teorisë në praktikë:

Si nis e shqetësohem për zhurmën që dëgjoj.  
Nga ana empirike, kjo zhurmë është e frikshme  
dhe kështu është, jo thjesht nga ana e jashtëza-  
konshme apo subjektive. Kjo është ajo që për-  
jetohet si qenie njerëzore. Por kur përjetoj zhur-  
mën si diçka të njohur, e kuptoj se nuk është e  
dëmshme për të keqen. Ajo është përplasja e  
hijes kundrejt dritares, për shkak të erës që fryn.  
Përvoja ka ndryshuar, e cila do të thotë se gjëja  
e përjetuar ka ndryshuar, pasi jorealiteti i lë ven-  
din realitetit, jo vetëm atij transcendental (të  
papërdjetuar). Realiteti ka ndryshuar, sepse e  
vërteta ka ndryshuar, por vetëm dhe thjesht se  
realiteti konkret i përjetuar ka ndryshuar. Tani  
ndihem i turpëruar nga frika ime; aq sa zhurma  
aq e tmerrshme shndërrohet në lëvizjen e per-  
des nga era, e për këtë arsye jam tepër mospër-  
fillës ndaj interesit im. Ky është ndryshimi i re-  
alitetit të përjetuar që ndikohet nga mjeti i aftë-  
sive njohëse. Kapaciteti i përvojës që do të vijë  
më pas konsiderohet padyshim në mënyrë kon-  
jitive më i vërtetë, sesa kapaciteti më i hershëm,  
por pa kuptimin më real. (Dewey, PIM, 395).

Ky nuk përbën një shembull rastësor. Pasi kur  
flitet për rëndësinë e kuptimit, Dewey ashtu  
sikurse pragmatistë dhe akademikë të tjerë si  
Charles Sanders Peirce, që është një nga ata që  
besonin në përfundime praktike dhe “pasoja  
logjike” të një fjalimi apo fjalie.

Vetë pragmatizmi sipas Dewey-it është i ngjash-  
ëm me atë që nënkuptonte për Purse-in dhe  
Xheims-in, por ai as që e përcakton fare, ashtu  
si duhet. Ai, jo gjithmonë sjell thënie pragma-  
tike dhe metoda pragmatike, por paraqet fokus  
të qartë për kuptimin e koncepteve filozofike,  
duke gjetur funksionin e tyre mbi përvojën dhe  
atë që realizohet në lidhje me qëllimet tona ndaj  
praktikave të suksesshme. Kjo në një farë  
mënyre lidhet me faktin se, sikurse përmendet  
pak më parë, dallimet e dualizmave tradicionale  
metafizike për Dewey-in qenë kryesisht palidhje  
me jetën praktike të njeriut, sidomos me analizat  
e nxjerra prej situatave relative dhe itinerarit të  
veprimeve të dëshiruara, apo të domosdoshme.  
Mbi të gjitha, pragmatizmi për Dewey-in kërkonte  
një lloj praktike humane apo diçka tjetër dhe,  
jo përkufizime që na zgjojnë, si ato të Alfred Jul-  
es Ayer-it: “Vlen të themi se askush nuk duhet  
të mashtrohet nga kjo praktikë sipas idesë se  
filozofi merret me kërkesa empirike apo metafiz-  
ike. Ne ndoshta mund të diskutojmë lirshëm për  
të, ndërsa analizojmë fakte, nocione, e të tjera  
gjëra. Por, duhet ta bëjmë të qartë se, këto janë  
thjesht mënyra e të thënit, se ai lidhet me përkufi-  
zimin e fjalëve korresponduese” (Ayer, 59).

Është në duar të sigurt të mendojmë se disa  
nga konceptet në filozofi, si e vërteta e përjet-  
shme, hulumtimi i fundit për njeriun dhe siguria  
epistemologjike qenë tepër abstrakte për prag-  
matizmin e Dewey-it, por ai e ka bërë të qartë, se  
gjuha për të është “në mënyrë të veçantë një  
model i ndërveprimit të dy personave, folësit  
dhe dëgjuesit, që presupozon një grupim të or-  
ganizuar të cilës i përkasin këto krijesa dhe prej  
të cilave kanë marrë zakonet e fjalimit” (NC, Dew-  
ey, 57). Gjuha, si teori e pragmatizmit sipas tij,  
duhet të shërbejë si informuese, edukuese dhe  
njëkohësisht praktike... Ai beson se, praktikën  
njerëzore përkthehen në forma të ndryshme të  
zbulimit të mjedisit. Gjuha e tij pragmatike lehtë-  
son barra për të zbuluar mjedisin më efektivisht.  
Sipas këtij kuptimi, shkenca linguistike nuk është  
shkencë e ndërgjegjshme. Sistemi gjuhësor synon  
të hyjë në mendjen tonë nga subkoshienca  
pa ndërgjegje, sepse gjuha është hartuar në  
mënyrë të veçantë për ta bërë më përgjegjëse  
gjithë teorinë e pragmatizmit. Ashtu sikurse nuk  
mund të jemi në dijeni për parimet që bëjnë ta  
jetojmë dijen e përftuar të veprave të tij, po ash-  
tu mbetemi në padije rreth ndryshimeve që ka  
sjellë gjuha e tij filozofike në atë mënyrë, sa  
shfaqet pragmatiste, sikurse edhe ndodh.

(Vijon në fq. 14)



# KRIJIMTARIA LINGUISTIKE E DEWEY-IT DHE PERFOMANCA E FILOZOFISË PRAGMATIKE



Në foto: Gjekë Marinaj

(Vijon nga fq. 11) Sipas hartimit, synohet dija, e cila përfaqëson sistemin lingvistik konjitiv të larmishëm. Dewey dëshiron të dijë sesi funksionon me ndërveprimin. Nëse duam të dimë se çfarë është gjuha pragmatike, duhet të pyesim, se për çfarë shërben kjo gjuhë? Cili është funksioni i saj? Një nga përgjigjet e njohura për këtë pyetje është se, gjuha e Dewey-it sjell dobi, jo vetëm se lidh ndërlidhjet konceptuale me stilin e duhur sintaksor, por edhe sepse përfundimet praktike janë më të thella ndaj alternativave të mundshme. Kështu në lidhje me lingvistikën pragmatike të Dewey-it “në një botë ku problemet e sjelljes bëhen çdo ditë e më të ndërlikuar dhe torturose, ekziston domosdoshmëria e madhe për të kuptuar gjuhën me të cilën parashtrihen këto probleme dhe marrin përgjigje” (Hare, 2). Kjo duhet bërë e qartë se, Dewey nuk po provonte të nxirrte gjuhën si art, por ashtu si një nga pasuesit e ideve të Darwin-it, ai është i ndërgjegjshëm se “sigurisht është gabim po të flasim për çfarëdolloj gjuhe si formë e artit, në sensin që është formuar në mënyrë sistematike dhe të ndërlidhur” (Charles Darwin, *Ndershmëria e Njeriut*, 61 *The Descent of Man*, 61). Synimet fisnike të Daye-it kërkojnë të sjellin një gjuhë praktike, e cila është e ndërlidhur, aq sa duhet për teorinë e pragmatizmit dhe praktike sa duhet për të qenë e instrumentalizuar më mirë me rëndësinë e pragmatizmit, nga sa do të ishte perceptuar. Gjuha, si burim dije, është e rëndësishme sipas tij, kur tema është në gjendje të njohë elementet kryesore të objekteve në procesin e mendimit. Sipas Dewey-it, një tjetër funksion i rëndësishëm i filozofisë është të realizojë thjesht teorinë e analizës, ashtu si funksionon në shkencat e njohura, në krijimtarinë e efektshme, në jetën e suksesshme të përditshme dhe për ta artikulluar atë, si dhe për ta bërë të vlefshme në zona të filozofisë dhe kulturës, të cilat ndoshta do t'i nevojiten. Ndaj për këtë arsye, ai e trajtoi dhe e konsideroi gjuhën si një nga mjediset më të rëndësishme të komunikimit, e cila “tregon se nuk ka tjetër, veç një fjale, simbolike të thjeshtë. Ekzistenca fizike është motori i kuptimit që mund të quhet në veçanti gjë e vogël, por artikulli i disa tingujve, apo sequenca e simboleve të tilla, mund të quhen gjuhë të thjeshta. Në fakt, nuk ka fjalë në rastin e parë dhe nuk ka gjuhë në rastin e dytë” (Dewey, EM, 81). Ai këmbënguli se arsimit, arti, politika dhe etika duan njëkohësisht të përshtaten në një farë mase me këto metoda që vërtetojnë se japin arritje në shkencë. Ideja fikse e besimit, ndoshta është thelbi që konsiderohej se ishte një nga mbështetësit e versionit të Peirce-it për mënyrën se si

kalojmë nga dyshimi në kërkim të besimit dhe e gjitha që përfshin është pika fillestare. Kjo nuk do të thotë, gjithsesi se Dewey ishte në marrëveshje totale me Peirce-in për sa i takon këtij funksioni filozofik. Ndaj së paku ka dy ndryshime kryesore nga filozofia e Peirce-it. Dorëshkrimi lidhet me faktin se, Peirce-it i pëlqen ta ndryshojë gjuhën e dyshimit dhe besimit në situata problematike, apo të papërcaktuara në fillim dhe deri me zgjidhjen përfundimtare të saj. Ndërsa Dewey, e sheh dyshimin paksa më ndryshe nga Hegel-i, i cili besonte se “dyshimi tek njeriu është pothuajse njësoj si për të bërë ndarjen nga mendja dhe shpirti” (Hegel, 333) gjë që thekson jo vendimin e dyshimit, por zgjidhjen e problemit. Për të shprehur mendimet e tij me atë qartësi që do të lehtësonte nevojat e tij pragmatike, Dewey iu kthye për ndihmë edhe një herë krijimtarisë lingvistikë dhe performancës pragmatike duke e ndërthurur mendimin me temën përmes një gjuhë të përshtatshme për punë. Me fjalë të tjera, ai fantazoi dhe përdori kode të fshehta gjuhësore dhe i shndërroi në fjalë. Po ta perifrzojmë Dewey-in, fjalët përfaqësuese, mbeten pjesë e një kodi përfshirës. Kodi mund të jetë publik apo privat. Kodi publik ilustron në çdo gjuhë që është e pranishme në një nga grupet e përcaktuara kulturore. Kodi privat është ai i cili pranohet nga anëtarët e grupeve të veçanta, në mënyrë që të jetë jo i saktë prej atyre fjalëve që nuk kanë nisur të artikullohen (Dewey, EM, 82). Për këtë çështje do të rezultojë analiza e detajuar e ndryshimeve të tij me Peirce-in drejt një linje të thellë mendimi që tregon pjesërisht, se ka vetëm pak ndryshim në fjalor, por kjo do të thotë pjesërisht, për të na kujtuar se analiza nuk zë vend në mendjen e organizmit, por në gjithë situatën me të cilën mund të keni një lloj ndërveprimi me mjedisin, manipulim të materialeve, qofshin ato në një laborator shkencor, apo në ndonjë ambient të ngjashëm dhe ndoshta mund të përfshijë më shumë se sa një person e kështu me radhë. Me fjalë të tjera, për të, analiza, përbën çështje të rrethanave aktuale. Ajo është zhvendosje në përputhje me parimin themelor të teorisë së gjuhës së Dewey-it, sepse “gjuha është mjet i përdorur për të transformuar disa faza të materialeve bruto nga përvoja në objekte të tjerë sipas një qëllimi. Nëse qëllimi është parashikim dhe kontroll, gjuha është shkencore” (Hook—Wienpahl, 271). Dewey përfshin tepër ndryshe veprimtarinë e brendshme të analizës. Peirce përqendrohet kryesisht në formën logjike të materialit që është deduktive, induktive, hipotetike. Nga ana tjetër, Dewey mbështet më shumë praktikën e shkencës eksperimentale për ta zgjeruar me tipare të analizës. Ai flet për parashkrimin e një problemi, lindjen e fakteve, hedhjen e hipotezave, arsyetimin, eksperimentimin dhe se si këto faza të ndryshme ndërveprojnë me njëra - tjetrën. Sipas termave gjuhësore, ai zbaton krijimtarinë e tij në këtë mënyrë; “Ndryshimi përfundimtar në të dyja llojet e kuptimit të gjuhës përcakton në mënyrë themelore ndryshimin midis asaj që quhet kuptim i zakonshëm dhe asaj që quhet shkencë. Në shembujt e mësipërm, tradita, kultura dhe fryma e grupit është faktori vendimtar në përcaktimin e kuptimit në përdorim” (Dewey, EM, 82). Këtu qëndron gramatika pragmatike, e cila përfaqëson më së miri kompetencat e shkencës gjuhësore. Kjo nuk është detyrë e thjeshtë, sepse “aftësia për të marrë dhe përdorur gjuhën përfaqëson një rritje të jashtëzakonshme evoluese” (Fromkin, Rodman, Hyams, 547), të cilin Dewey e transformon mjeshhtërisht në makinerinë pragmatike të komunikimit. Dewey i perceptoi njerëzit si krijesa me

zakone dhe dëshira, ku ashtu sikurse Niçja, ai besonte fuqishëm në vet-krijimin dhe zhvillimin e çdo anëtar të shoqërisë, pavarësisht statusit social. Në nivelet më të larta të këtij mendimi përcaktohej arritja e dijes përmes të mësuarit dhe të nxënimit. Në fakt, arsimit ishte një nga më të rëndësishmit për Dewey-in për të kuptuar shumë pjesë të filozofisë. Ideja për vet-krijimin, edhe pse nuk lidhej ngushtë me propozimin e tij se çdo qenieje njerëzore i duhen disa qëllime që mbështeten në përpjekjen për t'i bërë ato realitete mbijetese. Ai ndoqi udhëzimet e tij duke qenë vet krijues dhe mjeshter i pragmatizmit, jo vetëm në promovimin e ideve që e transformuan natyrën e shkollimit amerikan, por edhe në krijimin e gjuhës pragmatike prej tij për t'i dhënë jetë mendimeve dhe reformave të propozuara arsimore dhe sociale. Një nga pjesët më të rëndësishme të strategjisë së tij gjuhësore në shprehjen e domosdoshmërisë së arsimit në gjuhën pragmatike ishte aftësia për të krijuar metafora bindëse të fuqishme si më poshtë. Kjo përbente një lëvizje pozitive nga ana e tij, sepse ai mendonte se fjalimi konsiderohej, sa si dobi praktike, aq edhe si vlerë intelektuale kryesore: “Fjalimi ... përbëhet nga ‘fjalë të thjeshta’, tinguj që kanë gjasa të shoqërohen me perceptime, ndjenja dhe mendime që shfaqen të plota para gjuhës. Gjuha shpreh mendime, ashtu sikurse pompa që thith uj, edhe pse me funksione më pak transformuese, nga ç'tregohet në rastin e fuqisë së verës që ‘nxjerr’ lëngun e rrushit” (NC, Dewey fq. 51). Në këtë pikë ai pranoi Hegelin, i cili e konsideronte arsimit tepër të rëndësishëm. Për atë si dhe për Hegelin, mbi të gjitha filozofia shërben për mënyrën me të cilën plotësia kthehet në vet ndërgjegje. Hegeli e imagjinon gjithë historinë si proces edukativ, me të cilën kultura e njeriut bëhet edhe më e vet ndërgjegjshme dhe shndërrohet në përvojë. Shpresa e Dewey-it ishte ajo që do të thoshte, se më shumë mësues ishin profesionistë në fushat e tyre, duke shmangur tiparet e vjetra pedagogjike me një sistem më efektiv që sillte një shkencë më praktike dhe më pak libra, duke përdorur një gjuhë që do të ndihmonte t'i bënte këto hapa të mundshme dhe do të ndryshohej arsimimi jashtë mase në Amerikë. Domosdoshmëria ishte reale dhe ky opinion “pasqyrohej me forma të ndryshme përmes metodologjisë, e cila është tipike në shumicën e teksteve të metodave me nivelin e teknikës. Pjesa më e madhe e autorëve të këtyre teksteve pranojnë, se të katër aftësitë; dëgjimi, të folurit, leximi dhe shkrimi duhet të paraqiten në të njëjtën kohë, pa ndërhyrje të mëdha nga askush” (Oaks, 716). Madje edhe kur Dewey i këmbëu këto ide, arsimit mbetej ende themeli kryesor i filozofisë, sepse teoria e shkencës lidhej ngushtë me teorinë e nxënies. Gjuha pragmatike e Dewey-it, si e tillë, ishte pak a shumë e lirë nga të ashtuquajturat “fjalë profesioniste”. Ai mendonte se në frymën e filozofisë pragmatike, fjalitë tepër të gjata janë të mundshme nga ana teorike, por edhe tepër dyshuese, “Ka një ndryshim të qartë midis të pasurit dijen e duhur për të ndërtuar fjalë në gjuhë dhe për ta vënë në jetë atë. Për këtë ka një ndryshim midis asaj që dimë, e cila është kompetenca gjuhësore dhe mënyrës se si përdoret dija në ndërtimin e fjalimeve aktuale dhe në idetë, që përbëjnë performancën tuaj gjuhësore” (Fromkin, Rodman, Hyams, 12). Dewey krijoi dhe zbatoi një gjuhë që kishte potencialin për zhvillime të mëtejshme duke qenë në përputhje me besimin e tij pragmatik, se nuk ka arsye, përse njeriu duhet të ndalë së mësuarit para se ai apo ajo të ndahet nga jeta. Si përfundim, edhe pse John Dewey

nuk e krijoi pragmatizmin, ai i dha atij frymën lingvistikë, e cila ishte në tërësi marrëveshje me filozofinë e plotë pragmatike. Ai e morri me shumë seriozitet peshën e fjalës, pjesërisht sepse, “nëse një fjalë ndryshon kuptim në ndërlidhje me grupet e ndryshme kulturore, atëherë në këtë shkallë, komunikimi pengohet dhe për pasojë lind keqkuptimi” (Dewey, EM, 81). Pragmatizmi, si shkollë mendimi ishte aq i rëndësishëm për të, aq sa edhe krijimtaria pragmatike. Pa dyshim kjo gjuhë, në veçanti, u krijua për të mos korruptuar as stilin gjuhësor të përdorur nga kolegët e tij si Charles Sanders Peirce dhe William James as atë të përdorur nga filozofët e vjetër. Ndërsa e përcakton atë, sipas lidhjes me temën e rindërtimit të nevojshëm thotë se “kritika e pakëndshme e filozofive të së kaluarës nuk drejtohet nga këto sisteme në lidhje me urën e mëparshme sipas problemeve të kohës dhe vendit, por në lidhje me esencën në një situatë të ndryshuar njerëzore” (Dewey, Rec, in Phil, vii). Synimet e tij kanë vërtetuar të jenë edhe më fisnike. Krijimtaria e tij gjuhësore dhe performanca pragmatike nuk kishin misionin e interpretimit të botës në mënyra të ndryshme, por më shumë ndryshimin e saj. Ndaj në shumë forma, gjuha e tij nuk ndihmoi drejt këtij qëllimi. Kjo nuk lidhet me atë se, gjuha është “mjeti kryesor i qytetërimit dhe pa të, bota sikurse e dimë nuk do të ekzistonte” (Fromkin, Rodman, Hyams, 567), por sepse gjuha dhe mendimi janë epiqendra e çdo depërtimi filozofik. Nga ana profesionale, problemi kryesor i tij, që nga fillimi i krijimtarisë e deri ditën kur u nda nga jeta, gjendja e pragmatizmit dhe e ecurive ishte nën kujdesin e njerëzimit. Ashtu siç e vuri re natyrshëm Luois Menand, “pragmatizmi gjithmonë ka qenë i kujdesshëm ndaj rrezikut se ai do të shndërrohej në një disiplinë, e cila do të kthehej në një nga ato gjëra që sjellin mendimtarët profesionistë ... Pragmatizmi, që në shkakun e parë lidhet me mënyrën se si mendojmë dhe jo se çfarë mendojmë” (Menand, PR, xxvi). Kjo ka qenë një nga mënyrat e të menduarit të Dewey-it, kur qëllimisht përdori një gjuhë që ofronte një lloj pritshmërie pragmatike. Fjalitë e tij periodike shërbyen si zgjedhje përmes së cilës zhvilloheshin mendimet e tij. Kjo ishte në harmoni me teorinë e dyshimit. Gjuha e tij e mban lexuesin në ankth për frazën e ardhshme, megjithëse tema gjason me idenë se dyshimi krijon tension në lidhje me atë që do të vijë më pas. Kjo i përket një strategjie lingvistikë që e bën shkrimin edhe më efektiv, për shkak se ndryshon aktualisht përvojën tonë dhe nivelin e të kuptuarit mbi idetë e tij në mënyrë pozitive. Besimi se komunikimi është i rëndësishëm në përmirësimin e kushteve të shoqërisë, deri në një farë mase, pasi “nga të gjitha çështjet, komunikimi është nga më të mrekullueshmit ... Kur fillon komunikimi, të gjitha ngjarjet e zakonshme i nënshtrohen rikonsideratës dhe ripërtëritjes; ato ripërshtaten për të përmbushur kërkesat e bisedës, qoftë publike, apo bisedë që paraprakisht quhet filozofi” (Dewey, E&N, 138). Ndaj po e them sërish, se për Dewey-in, qeniet njerëzore janë krijesa me zakone dhe instinkte, aq sa ndryshe nga Niçja, ai beson fuqishëm në vet-krijimin dhe evoluimin e çdo anëtar të shoqërisë, pavarësisht statusit social. Gjuha e tij pragmatike është teori tepër e rëndësishme, “drejtuar nga modeli” dhe e konvertuar në mënyrë pragmatike në praktikë. **FUND**

Gjekë Marinaj

Përktheu nga Anglishtja: Irena Papingji



Horizonti "pritës" i studiuesit Gjekë Marinaj si bërthamë e një globalizmi protonizmit...

# Nacional si frymëzuese e levizjeve të reja letrare

"Shohim se idetë protonizmit të z.Marinaj kërkojnë ndershmëri deri metafizike. Sepse nuk kërkohet vetëm lexuesi i zakonshëm, por t'i jepet atij dhe e drejta, që kritika të jetë "kodi" zgjedhor në këtë pritje të zgjedhurish "politik"

Nga Ilir Paja



Nuk është "takimi" i parë me një krijues dhe studiues si Gjekë Marinaj. Mendoj, se dhe një referencë biografike ndoshta do ta tejkalonte vetë biografinë e tij. Por shkurtimisht do ndalesha në dy momente jete dhe ekzistence. I larguar nga atdheu dhe i gjendur sot në podiumet e inteligjencës amerikane, ( për veprën e tij cili do lexues mjafton të klikojë dhe do e ketë të thjeshtë, të kuptojë se, 20 vite arsimim, vepër krijuese, takime, prezantime të artit dhe kulturës sonë do mjaftonin t'i jepnin një titull, atë të një "kongresmeni" të kulturës shqiptare ).

Ndalar në numërin 123 dhe më pas numëra të tjerë të gazetës mbarkombetare "Nacional", kemi dyherësh shkrime nga z.Marinaj, ( këtu nuk po përmend jo pak esetë e tij mbi risi dhe interpretime mbi eposin tonë kombëtar "Cikli i Kreshnikëve"). Në të parin lexojmë interpretime të artit fotografik dhe në të dytin, kemi prezantimin e poetit P.Zogaj dhe poezisë së tij në Amerikë. Këtu do veçoj dhe një kapërcim oqeanik të veprës së Kadaresë, përfaquar plot dëshirë shqiptare dhe ballkanase të njohjes, perceptimit tek amerikanët, inteligjencën krijuese dhe studiues të saj mbi shkrimtarin që Nobeli i qëndron mbi krye si kurorëzimi nga Papa i Skënderbeut, por që s'mundi t'ia vendosë dot...Dhe këtë prezantim e kreu më së miri kritiku studiues i një teorie letrare **protonizmit**, Gjekë Marinaj. Ndoshta për lexuesin jo të zakonshëm, por, që unë do ta quaja lexuesi masiv e pak aktiv, po rendis çështje, që kjo risi interpretimi kërkon si kalorës real, e jo donkishotesk, të përçojë lajmin e një fitoreje prej Maratonaku: *Jo të lajmet vetëm fitorja, por të çmohet përjetësisht ndershmëria e saj!*

Prej protonizmit kemi "krijesat" si ide të saj: 1). Lexuesi dhe studiuesi të piren drejtë ndershmërisë intelektuale dhe impulseve etike të saj. 2). Dialogu serioz në qëndrimet filozofike të kritikës në letërsinë globale. 3). Idetë në ndihmë të esencës historike. 4). **Vepra e autorit dhe jo reputacioni i favorshëm.** Këtë të fundit unë do ta quaja si *pyllë* por e "dënuar" të mbetet jetimë... Siç shohim, kjo teori sa letrare, por më shumë gjithë intelektuale në dobinë e njerëzores, kërkon të kulmojë në qëllimin ( jo pak të përfolur si përherë nën zë ), të të parit me dashamirësi të veprës dhe jo "vetëshkatërruar" nën kompleks, herë-herë dhe inferior.

Duke shfletuar temat, për të cilat protonizmi e trajton letërsinë dhe artet, vëmendja ndalon tek virtualiteti krijues përballë njeriut të zakonshëm. sipas studiuesit Marinaj, protonizmi ka të bëjë me një elektron pozitiv + 1, i cili gjendet në bërthamën e atomeve. **E nëse do kërkoni këtu "super" dhuratë vetëm energji pozitive, tash në kapërcyell të 100 vite të lindur e vdekur dhe njëherësh, një ide interpretative në art, veçanërisht në letërsi, duket si prishmëri e një "tranfuzioni" gjaku, ku na duhet tanimë e mbrapa të ushqehemi në shëndetin**

mendor-qytetar me një **bërthamë atomike-një komb dhe me një energji + 1 pozitive = humanizëm!** Në veprën e estetit francez Raymon Aron me titull "Opiumi i intelektualëve", flitet në kapitujt e tij nga idetë majtiste, djathtiste, jo "ideologjike" amerikane, deri tek llojet, format e revolucioneve. Në këtë prizëm, libri vë theksin jo tek vepra e tyre, poetë, shkrimtarë, ideologë deri tek filozofët, sesa tek "helmimi" i tyre gati natyrshëm, sepse ata i dhuruan **fatkeqësisht** ideologjive humanizmin. Sipas studiuesit Aron, këtu nis religjioni **fe** i shek XX. Autori citon se reformat shoqërore janë **prozaikë**, vetëm imazhi i revolucionit mbetet **poetik**. Nga kjo kuptojmë se ashtu siç të emocionon një poezi pak çaste, ku shpirti e lë veten të mbivendoset mbi gjakun në trup, aty nis dhe gabimi drejtë fajit tone të pashmangshëm, ( tek ne për gati 50 vjet), por mëkatet e një "çasti" kaq poetik në fund të **recitimit** "numërojnë" vetëm poetin...të tjerët u vranë si në padukje. Kultura, sipas R.Aron, u jep sjelljeve shoqërore dhe institucioneve të ndryshme, si janë familja, puna, shpërndarja e pushtetit dhe e prestigjit, forma të panumërta, të pashkëputura nga besimet metafizike apo nga doket e përligjura nga traditat. Në këtë "globalizem" social ( mendoj) se z. Marinaj përmes protonizmit kërkon, që artin dhe më shumë duket letërsinë, ta ngrejë në kultin e një horizonti gjithëpërfshirës, ku pritjet të jenë "traditë" "ndershmërisht! Kjo duket se përngjan me idenë më të shëndetshme si europiane, por dhe jo pak amerikane, në atë, që do ta postulonim si epilog dhe prolog njëherësh: "**Huanizmi i më të mirëve nuk do pengojë që humanizmi të shtrihet te të gjithë**". Shohim se idetë protonizmit të z.Marinaj kërkojnë ndershmëri deri metafizike. Sepse nuk kërkohet vetëm lexuesi i zakonshëm, por t'i jepet atij dhe e drejta, që kritika të jetë "kodi" zgjedhor në këtë pritje të zgjedhurish "politik"...Duke cituar vepën e mësipërme të z. Aron kemi se: Fundi i historisë është një mendim i Arsyes dhe karakterizon jo **njeriun e veçantë**, por përpjekjet e njerëzve, të tubuara gjatë rrjedhës së kohës. Ai është "projekti" i njerëzimit, përderisa ky njerëzim e quan veten të arsyeshëm. Kështu, sipas mendimit tone, studiuesi Gjekë Marinaj nuk "shfleton" ide letrare, se sa krijon për letërsinë. Nëse kemi një krijues, kemi njerëzit "përdorur" si imazhe të tillë. Ndaj vepra letrare është e tyre. Artisti, duket se vetëm tek ia dhuron pret prej tyre të "zbulojnë" këtë energji pozitive, të cilët njerëzit duket se e harrojnë, jo pak dhe vetëdijshëm... Tani kemi letërsinë tone, mjaftë komplekse në identitet, kjo vetëm pas vitit 1945. Pothuaj çdo vit, shtypi, mediat, auditorët universitare, konferencat shkencore, botimet brenda dhe jashtë, kërkojnë t'i japin asaj, pra letërsisë post vitit 45 jo vendin (dikur), por rolin e atëhershëm sa censures, por dhe aq **auto-censures**. Po citojmë sërish veprën "Opiumi i intelektualëve" ku lexojmë, se në art barasvleri i

së vërtetës është **cilësia**. Në rastin tone kjo "cilësi" ishte jetesë mbijetesë, thënë më thjeshtë; një shoqëri që ushqehet me shpresa idesh, se sa prekte të mirat materiale. Përfundimi: një art ku mediokriteti vetë kishte nisur të kishte si "uri po aq dhe etje"...Gjithsesi autori që "mbijetesën moderne" e ngriti në legjendë **historike** ishte Kadareja. Krijoi kryeveprën e një atdheu, ku e shkuara duket se "ngushëllonte" të tashmen...Për të mos **vetëshkatërruar të nesërmen!** Protonizmi ose më saktë "jam" pro! I një vazhdimësie **izmash!** Kjo ka dhe arsyen e vet mendojmë. Sot në termin Globalizëm, arti dhe letërsia gjendet në "pragun" nga ku duket se do dalë për të krijuar një strehë të Re! Sipas z.Marinaj duket se Ai e ndjen këtë prishmëri. Jemi në **post-modernizëm**, kur na duhet të pyesim: po pas saj???...Anëtarët e familjes oborrtare disa shekujllorë të **IZMAVE**, nga Klasicizmi e deri tani në post modernizëm, ( këtu përjashtoj Realizmin Socialist. Ky "fëmijë" fatkeqësisht bir tenardiesh...por që "pijnë" nga i njëjti gjak vëllezëror me Gavrosin...), na japin jo zgjidhje, as një prijje që mund ta pëlljë një shtet-planet. Duket se përpos teorisë së interpretimit Protonizëm, do kemi një teori humaniste më parë. Arti sot, në mbi vitet 2000 është më shumë "arsye" e mendimit se sa "krijesa" muzash. Kjo ka një shpjegim

## U mbajt tribuna "Dasma Shqiptare në Preshevë e rrethinë, dikur dhe sot"



Për dy ditë rresht zhvilloi punimet e sesionit shkencor të Tribunës shkencore, në Shtëpinë e Kulturës "Abdullah Krashnica" mbi dasmën shqiptare rreth 20 referues vendor dhe mysafirë, studiues nga gjitha trojet etnike shqiptare, nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia. Nën organizimin e Shoqatës për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturorë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje

teorik dhe real. Njerëzimi pothuaj përfton gjithë llojet e dijeve, e për të mbërritur tek metafizika, dijes i duhet arti si ende betejë me irealen pa u zbuluar, dhe, jo një lexues, por të gjithë njëherësh. Ndoshta thënë në mënyrë figurative, letërsia ndjek pas akoma njëherë endërr të dijes! E atëherë, nëse idetë sipas protonizmit janë në kërkim të esencës historike, studiuesi i mësipërm yni, na dhuron mjetin e vetëm për të mbërritur tek e vërteta absolute e artit, atë të mbërritjes tek Ai njeri, që ka kohë që ndjek imazhin më metafizik, fshehur por pa ndrojtjen "favore" si autorësi! Në idetë amerikane mbi shoqërinë thuhet: Se idetë shkojnë bashkangjitur me rendin real, pa i tradhëtuar mendimet dhe pa flijuar rendin! Ajo, që mungon në shoqërinë shqiptare, ka të bëjë, me atë, që rendi flijohet para gjithçkaje, kur sipas një përfaqësuesi të denjë në diasporën "moderne", atë të z.Marinaj, humanizmi duhet të jetë jo ideja gjithëpërfshirëse, por **kodi gjenetik modern!**

është mbajtur sesioni shkencor i Tribunën me temë: "Dasma Shqiptare në Preshevë e rrethinë, dikur dhe sot". Në këtë tribunë janë shqyrtuar dhe trajtuar një sërë raportesh nga referuesit, kryesisht studiues dhe njohës të mirë të traditës sonë kombëtare, mbi dasmën shqiptare në rajonin e Preshevës, Bujanocit, Medvegjës, Gjilanit, Shkupit, Kumanovës, e shumë vende tjera shqiptare. Pjesëmarrësit e kësaj konference janë studiues vendore dhe mysafirë nga gjitha qendrat shqiptare si: Prof. Dr. Mustafa Ibrahim, Demir Krasniqi, Hysen Këqiku, Mr. Hajrulla Mustafa, Xhemaledin Salihu, Mr. Mustafë Haziri, Enkel Rexhepi, Amir Latifi, prof. Dr. Agron Xhagolli nga Instituti i Kulturës Popullore në Tiranë, prof. Dr. Hamit Xhaferi, prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj, Leonora Shkurtaj, prof. Dr. Nebi Dervishi, Riselda Sejdiq, Jonuz Fetahaj, Mr. Ferid Selimi, Dr. Nevrije Bislimi, prof. Dr. Fatmir Sulejmani, Akademik prof. Dr. Aleksandër Stipçeviq, Dilaver Kryeziu, Sami Pirraj, Dr. Hatixhe Ahmed, Av. Agron Isa Gjedia etj. Kryetari i shoqatës për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturorë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, Z. Xhemaledin Salihu e hapi këtë tribunë shkencore me një fjalë pershendetese.



“Protonizmi, si një “teori konkrete”, përvijim i një sistemi vlerash

# Teoria protoniste duhet të mësohet në universitetet shqiptare

“Por, a e progreson (ushqen) teoria e protonizmit shpresën se pas një “virusi” që mund të përhapet ndër kritikët tanë (sin do Zot) si një reflektim, do të mund të paqësojë pH-in e shkrijmtarisë në Shqipëri apo janë thjesht ëndrra në diell? Kimia e shkruesve në Shqipëri ka nevojë për një elektrodë drejtuese, orkestruese, e gati publike për të drejtuar elektronet e kaosuara të lexuesit. Por, a ka terren të përshtatshëm për zhvillimin e pozitivizmit protonik të z. Marinaj?”



Kur lexova librin “Protonizmi” i Marinaj, botuar nga Shtëpia Botuese “Nacional”, më la përshtypjen se ai do ta lexonte me dëshirë një veprë të lënë mbi tryezën e punës, edhe pa emrin e autorit dhe të atij që mund ta kishte referuar, duke menduar për tingëllimën e ndjesisë që vepra i la, ashtu siç bën një i verbër, i cili përvijon në mendje çdo detaj të sendit që përdëgjon të bjerë e të zhurmohet përtokë. Protonizmi i tij më la përshtypjen se ai është fillimisht “lexues”, një lexues i shëndetshëm. Dhe të gjithë e dimë se nuk është e lehtë të jesh lexues. I keni vënë re promovimet e zakonshme të aksh autori? Vetë shkrimtarët, kolegët e atij që “nunëzon” veprën, nuk marrin mundimin ta shfletojnë librin që i ka dhuruar autori (i cili gjithnjë rri me shpresën se dikush do ta përflasë siç duhet veprën, jo jetën private të tij), duke e shndërruar promovimin vetëm në një vend sehiri ku pihet ndonjë gotë verë e flirtohet nga pak. Pra, është vështirë të jesh lexues i mirë, t’i lesh të lira ndjesitë e tua të shkojnë aty ku një “e thënë” të ngacmon mendjen, të bën përshtypje, të bën të përfutosh natyrshëm perceptime, ndjesi, shije; është vështirë ta lësh hundën të të drejtojë në vend të syve apo veshëve. Dhe, pastaj, pas një rileximi, vjen shtjellimi i mendimit kritik, tjerja. Kjo gjithnjë më ka ngjarë me ripërshtypjen e ushqimit nga lopët: ulur rehat, me pikëpyetje nëpër dhembë, qetë-qetë, duke vështruar horizontin. Por jo të gjithë e dinë se procesi i tretjes nuk përfundon te gjuha.

Kritiku është shkopi i të verbrit për letrarin, kryesisht për poetin, të cilit tashmë i është tronditur edhe piedestali, edhe auditori. A është në problematikë kaq horizontale edhe letërsia në botë? Kam përshtypjen se jo, sepse, përveç institucioneve analizuese dhe vlerësuese, atje funksionon edhe përzgjedhja e enteve botuese, gjë që këtu tek ne ende nuk është kanalizuar. Ta them më thjesht: nëse atje funksionon mbledhja e diferencuar, ne i fusim të gjitha në një kosh. Filtri i parë është pikërisht shtëpia botuese, të cilës i drejtohet një autor. Ajo merr përsipër jo vetëm miratimin (nëse kjo veprë i përshtatet politikës dhe synimeve të saj, veçori me të cilat ajo ka krijuar fytyrën dhe lexuesin e saj), por edhe promovimin dhe prezantimin para

lexuesit. Nuk ma merr mendja se në Shqipëri të drejtoresh në një shtëpi botuese (edhe sikur të kesh bërë veprën më të turpshme të mundshme), të ndodhë të ta mbyllin derën. Mjaft të paguash. Kjo gjë sjell një kaos, një mjegullnajë ku të gjithë ngatërrojnë këmbët. Kjo bën të ndodhë që kritiku, për të gjetur “lëndën e parë” për studimin e tij (edhe pse ofertat për kritikën janë kaq të dendura sa stendat e tregtarëve në tregun e madh) të mos jetë gjithnjë i kënaqur me atë që gjen apo i vjen në dorë.

Por, është e pranueshme nga të gjithë se një sipërmarrje revolucionarizuese është kryekëput e vështirë, dhe, jo vetëm sepse duhet të prekë të dyja brigjet (letrarin dhe kritikun, të cilët së bashku bëjnë produktin), por kryesisht për faktin se filtri rrezikon të përmytet nga tejmbushja me pretendues se shkruajnë (ata botojnë shpesh në rrjetet sociale, por shkruajnë si trup i vetëm, gjysmat në formate klasike të vjetruara, gjysma tjetër kokë e këmbë në hir të modernitetit, duke krijuar abstragime që as vetë nuk i kuptojnë). Ata nuk dinë çfarë janë dhe çfarë bëjnë. Dhe, ta kapësh hollë, as që u duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Edhe kritikët në Shqipëri janë ndarë në dy rryma: kritikët “profesionistë”, të cilët marrin rolin e peshkatarit, të peshkatarit të llojit tangarllik, që kur u bie në grep një peshk i vogël e lëshojnë në ujën e vet (sepse shumica syresh vuajnë kompleksin: “je i madh kur merresh me të mëdhenjtë”), ose ndodh kryekëput e kundërta me kritikët e dorës së dytë, të cilët për çdo fije autori që u del para, e fryjnë shkrimin si aerbag, duke pretenduar se kanë zbuluar talentin e shekullit.

A ka shpresë një talent, sado në filllesa, të shpresojë se vepra e tij “e bërë mirë” do ta përftojë lexuesin e vet edhe pse “peshk i vogël” (sepse, të jemi të ndërgjegjshëm: një poet apo shkrimtar i afirmuar, i ngujuar tashmë në murin e letërsisë, dihet që e ka të sigurt, si lexuesin, po aq edhe kritikun e tij)? A ka një shpresë se nëpërmjet një kritike të mirë e profesionale lexuesit t’i bjerë muri i ftohtësisë e do të rendë sërish pas ushqimit të tij të shëndetshëm, një letërsie po aq të mirë, me të cilën ai qe mësuar? Pra, në këtë kuptim, kritiku nuk është më shumë në funksion të shkruesit, sesa në funksion të lexuesit, të cilit po i vyshket përditë dëshira të lexojë eksperimentalitete, duke qenë se e ndien mungesën e vlerësimit profesional. Lexuesit kanë nevojë për “fletë të verdha” të qytetit të shkruesve, në mënyrë që të ndihen “qytetarë të letërsisë”. Sa shpesh nëpër kohëra poetët, me gjakun e guximit kanë shqyer tabutë, zinxirët, teroret më të egra, duke ngritur në revolucion mendjesor e kulturor njerëzit! A mundet kritika të luajë rolin e një bakteri ekuilibruar që shndërron në vaksinë për të shëruar letërsinë nga zallamahia e kaosit të zhurmshëm ku është zhytur?

Duke lexuar Gj. Marinajn, shkrimet dhe teorinë e tij protoniste, duket sikur kjo është e mundur. Këtë shpresë e ndien kur lexon se për të shpre-

hur mendimin e tij për veprën e dikujt, atij i vjen natyrshëm, pa sforcime, pa lajlelule, pa stërgjitime, “duke i rënë gjërave në kokë”, gjë që tregon profesionalizëm, duke i siguruar lexuesit shpresën se kritika “është shëndoshë e mirë”, është e “hapur për publikun” dhe, këtë të fundit të bën ta besosh teorinë e tij mbi protonizmin.

Por, a e progreson (ushqen) teoria e protonizmit shpresën se pas një “virusi” që mund të përhapet ndër kritikët tanë (sin do Zot) si një reflektim, do të mund të paqësojë pH-in e shkrijmtarisë në Shqipëri apo janë thjesht ëndrra në diell? Kimia e shkruesve në Shqipëri ka nevojë për një elektrodë drejtuese, orkestruese, e gati publike për të drejtuar elektronet e kaosuara të lexuesit. Por, a ka terren të përshtatshëm për zhvillimin e pozitivizmit protonik të z. Marinaj? A do të drejtkuptohet teoria e tij? E keqja është se terreni praktikisht është i karamelosur më shumë se ç’duhet. Ka autorë të rinj (një prej të cilëve jam) që parapëlqejnë të fshihen në ferrën e vet (tkurren të krijojnë familjen e lexuesve të tyre të dashur e të ngrohtë), sesa të pranojnë që kritikët ta bëjnë raketake veprën e tyre, duke fyer kështu edhe lexuesin, edhe shkruesin. Por, këta janë të paktit, sepse të shumtët nuk e kuptojnë dhe kapen pas kritikëve si i mbytur pas fijos së barit (pa e kuptuar se fija e barit është po aq lundruese në rrjedhë, po aq sa ata), thjesht sepse atyre u leverdis, sepse vetëm kështu mund të dalin në sipërfaqe: kanë nevojë për pasaportën e emrit të kritikut. Kritikët, çuditërisht ngjashëm, i mbushin shkrimet me lavde, prej të cilave u vjen era lajkë. Kjo ndodh sepse, ndryshe nga kudo, kritika paguhet nga autori, ose ka raste, kur njëra nga palët është femërore, marrëdhënien e tyre e drejton gjilpëra magnetike e flirtit. Ky lloj “korrupsioni moral”, duket se do të ketë jetagjatësi sa kohë që shkrimet kritike nuk do të lindin prej cytjes së autorëve, por do të lindin si nxitje e pasionit, ngacmim i profesionit të kritikut. Por, a keni menduar ndonjëherë se ç’përqindje pozitivizmi (protonizmi) mbart ky “terren” vlerësimi lajkor që përmendëm pak më lart? A nuk mendoni se kritika te ne, si fillim duhet të tregojë tehu e saj krasitës, në vend të “ujtjes ledhatare”? Pozitivizmi (protonizmi), a do të kuptohet drejt nga përdoruesit e tij këtu te ne?

Kritika ka nevojë të krijohet nga individë dhe të merret me vepra, jo me mendësinë “mall shumice” për konsum. Me shkrimin e tij kritiku pothuajse përcakton “bar-kodin” e një veprë, natyrisht duke bërë kujdes se interpretimi kritik është “vepra e tij”, është emri i tij, është ai “dorëzani” mes krijimit dhe lexuesit. Është e kuptueshme që kritikët të jenë të paktë në numër (ne kemi universitete “prodhuar artistë”, nuk kemi as degë të vetësishme për të shkolluar kritikë arti) dhe, duke përjashtuar të dobëtit dhe eksperimentalët, ata mbeten pak sa gishtat e dorës, gjë që ia shton përqendrimin problematikës. Ne “ecim me hapin e kohës” në ofrimin e

Nga Rudina Çupi



teknologjive, shërbimeve dhe bizneseve më bashkëkohore, por ende deri më sot nuk ka bërë përpjekjen serioze për të synuar të ndërtojë një institucion vlerësimi. Të thuash se për këtë nuk është nevoja, nuk ma do mendja, sepse, a i keni numëruar sa organizata të ashtuquajtura letrare hapen çdo vit e që vardisen të grumbullojnë sa më shumë artdashës të vegjël, (të cilët janë të panumërt), duke vënë në karrem emrin e ndonjë të madhi, bëjnë ndonjë konkurs e shpërndajnë dy-tre çmime (cilësia e të cilëve është shumë larg të vërtetës). E gjithë situata lyp nevojën që të bëhet diçka lidhur me këtë.

Siç e vutë re, besoj se pikërisht kritikës profesionale i bie barra në një farë mënyre ta marrë situatën në dorë, për të bërë diçka të mirë për letërsinë (dhe për veten), e cila çdo ditë e më shumë po shndërrohet në pellgaçe. Të gjitha këto pikëpyetje shtrojnë kërkesën konkrete që kjo të institucionalizohet në sferat shkolluese të shkencës së kritikës dhe jo vetëm të fushatizohet. Do donim që teoria protoniste të kishte projekte të realizueshme në universitete shqiptare që shënjestron profesionalizëm të nevojshëm për të gjithë. Protonizmi, për të cilin flet dhe praktikon z. Marinaj, shpresojmë të gjithë të jetë një “teori konkrete”, përvijim i një sistemi vlerash (natyrisht, duke respektuar shijen e shumëllojshme të letërsisë).

E solla të gjithë këtë problematikë e shtyrë nga shqetësimi (sepse, siç themi në shqiptarët: “gjuha vete ku dhemb dhëmbi”) dhe nga shpresa që ndjeva kur lexova pjesët kritike të z. Marinaj, duke parë në të kritikun profesional për të cilin ju fola pak më lart e për të cilin të gjithë do të kishim nevojë të gjithë, por që pa dashje i kam sugjeruar atij një rol, për të cilin nuk di sa është e mundur ta vërtetësojë. Unë ju fola si një lexues që pëlqen gjënë e bërë mirë (krijim të jetë kjo a kritikë); unë ju fola vetëm për shpresë... I uroj z. Marinaj sa më shumë punë të frytshme e të kënaqshme, për veten dhe për ne!